



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:**

**“Administrim Biznesi”**

**Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Asoc.Dr. Etleva Leskaj**

**Dr.Alba Skëndaj**

**Korrik / 2023**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Master Profesional në: “Administrim Biznes”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Administrim Biznes
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në: “Administrim Biznes”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 652 dt.14.09.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 79, datë 31.05.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE / 1 PAK Bazuar në ngarkesën mësimore rezultton: 89 %PAE ; 11% PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022 13 studentë; 2022-2023 17 studentë;
19	Komente / të tjera:	

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznes është një program i ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë i cili ofrohet nga Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'. Ky program studimi është miratuar me VKM Nr. 672, datë 14.09.2011. Kohëzgjatja e programit është 1 (një) vit akademik i ndarë në dy semestra. Programi MPAB ka 60 kredite të cilat janë të ndara në të dy semestrat. Marrja e të gjitha krediteve i jep mundësinë studentëve të paisen me diplomën që ofron ky program studimi.

Misioni i programit MPAB është ofrimi për studentët i aftësive për të qënë pjesë e suksesshme e tregut të punës. Për arritjen e misionit dhe objektivave të këtij programi, njësia përgjegjëse për ofrimin e tij ka hartuar kurrikulat të cilat do të mundësojnë paisjen e studentëve me njohuritë thelbësore të menaxhimit. Pjesë të kurrikulave të këtij programi janë përfundimi i njohurive teorike dhe praktike në fusha të tilla si: manaxhim projektesh, manaxhim shpërblimi, menxhimi i sjelljes në organizata, lidhshëm, marrjen e vendimeve të duhura manaxheriale, administrim publik dhe aftësi menaxheriale. Në këtë program është përcaktuar dhe rritja e aftësive praktike apo vënja në praktikë e dijeve teorike të përfunduara nëpërmjet praktikës profesionale.

Programi i studimit Master Profesional në "Administrim Biznes" është pjesë integrale e programeve të studimit të nivelit të dytë që ofron Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit Aleksandër Xhuvani Elbasan. Programi i studimit MPAB ofrohet nga një prej gjashtë departamenteve që ka ky fakultet dhe konkretisht nga, Departamenti i Administrim Biznesit. Departamenti i cili është përgjegjës për programin është një departament i konsoliduar dhe me një staf pedagogjik të brendshëm dhe të jashtëm me eksperiencë në mësimdhënie e me grada shkencore duke u konsideruar si garant për plotësimin e standarteve të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Në të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga UNIEL, shpejgohen qartë dhe në mënyrë të detajuar qëllimet e programit, objektivat e tij, të cilat perputhen plotësisht me nevojat për punësim, kërkesat e tregut të synuar, apo nevojat dhe mbështetjen që institucioni i bën biznesit dhe entiteteve vendase në sektorin publik edhe atë privat, përmes këtij program.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Në datën 1.12.2022, Universiteti Aleksandër Xhuvani ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Master Profesional në "Administrim Biznesi". ASCAL bazuar në manualin "Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit", përzgjedhi dy vlerësues të jashtëm të cilët bazuar në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) si dhe Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB), të programit të studimit Master profesional në "Administrim Biznesi" të Universitetit Aleksandër Xhuvani dhe në vizitat e kryera në këtë institucion, kanë hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të programit të ciklit të dytë të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi". Për hartimin e raportit, veç raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën 2 ditore që grupi kreu në institucion, si dhe mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Zyrës së Standardeve dhe Cilësisë, etj.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga Prof. Asoc.Dr. Etleva Leskaj dhe Dr. Alba Skëndaj. Gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ u asistua nga koordinatori teknik i ASCAL, Z/Znj Majlinda Demirneli. GVJ-së ju vu në dispozicion i gjithë dokumnatcioni i dorëzuar nga UNIEL (DVV) në datën 9.11.2022, pas shqyrtimit të këtij dokumnatcioni nga GVJ, u hartua dhe agjenda e vizites në institucion, të cilat u zhvilluan në datat 12 dhe 13 Janar 2023, në ambientet e institucionit. Gjatë vizitave ekspertëve ju vendos në dispozicion një sallë e dedikuar për të kryer takimet e planifikuara sipas agjendës. Ndërkohë që u kërkua dhe dokumentacion shtesë i cili ju vu në dispozicion GVJ. Bazuar në DVV, në intervistat me pyetje të përcaktuara të GVJ, sipas fokus grupeve të përcaktuara në agjendë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm paraqet Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të programit Master Profesional në "Administrim Biznesi". Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimit të cilësisë, etj. Në përfundim të këtij Raporti, paraqitet në formë të përmbledhur një analizë përfundimtare mbi programin e studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi", si dhe rekomandimet përkatëse për institucionin.

Universiteti Aleksandër Xhuvani është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 24.05.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 2/80 Prot, datë 24.05.2023. Universiteti Aleksandër Xhuvani më datë 01.06.2023, njofton nëpërmjet sistemit AMS me anë të shkresës me Nr. 642/64 Prot, datë 01.06.2023, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Administrim Biznes”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani" (UNIEL), ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Ky program studimi master profesional në Administrim Biznes synon të përgatisë profesionistë që do punojnë në sektorin privat, publik dhe OJF. Ky program studimi, sikurse dhe të gjithë programet që institucioni ofron, synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Kjo parashikohet dhe në Statutin e UNIEL.  <i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit të ciklit të dytë ‘Master professional në Administrim Biznesi’ është hartuar në përputhje me ligjin e arsimit të lartë. Programi i studimit gjithashtu është i hartuar dhe mbështet qëllimet dhe misionin e institucionit në fushën e veprimtarisë akademike.  <i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Bazuar në RVB si dhe në rregulloret e UNIEL, program i studimit Master Profesional në Adminisrim Biznesi është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit të institucionit dhe rregulloreve të tij në përputhje të plotë me fushat e studimit dhe drejtimet akademike. Misioni i këtij institucioni fokusohet në zhvillimin e dijeve përmes mësimdhënies dhe mësimnxënies, kërkimin shkencor dhe përmirësimin e vazhdueshëm bazuar në prioritet kombëtare. Vizioni, misioni dhe qëllimet e institucionit theksohen dhe në

	<p>statutin e UNIEL, dhe të gjitha instancat punojnë për arritjen e tyre.</p> <p><i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prinjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit synon të krijojë specialist për tregun e punës në fushat menaxheriale të cilët të jenë të aftë të punojnë në sektorin privat dhe atë publik. Ky program bazuar në planin e plotë të tij, Syllabuseve të lëndëve dhe Planit Strategjik të Programit, evidentohet që është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Të diplomuarit në këtë program studimi fitojnë njohuri teorike dhe aftësi praktike në një gamë të gjërë të fushave të menxhimit. Studentët të cilët zotërojnë një diplomë të tillë mund të punësohen në institucione të ndryshme bazuar në njohuritë që kanë marrë. GVJ evidentoi që program i studimit është mbështetur në dokumentacionet dhe ligjet e vendit.</p> <p><i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.16 Studimi (periodik) për tregun e punës</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.20 Strategjia e zhvillimit të Departamentit Administrim Biznes</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion vlerëson se programi Master Profesional në Administrim Biznes në UNIEL është i hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimet e institucionit. Gjithashtu ky program studimi është në përputhje me strategjitë zhvillimore dhe interesat kombëtarë dhe mbështetet në rregulloret dhe Statutin e institucionit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	
			<p><b>X</b></p>	

**Standardi I.2**

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, i cili ka 5 (pesë) departamente dhe 1 Qendër:</p> <ol style="list-style-type: none"><li><b>1. Departamenti Administrim Biznes;</b></li><li>2. Departamenti Ekonomiks;</li><li>3. Departamenti Financë Kontabilitet;</li><li>4. Departamenti i së Drejtës;</li><li>5. Departamenti Marketing dhe Inxhinieri;</li><li>6. Qendra për Kërkime dhe Zhvillime Ekonomike;</li></ol> <p>Programi Master Profesional në Administrim Biznesi i ofruar nga Departamenti i Administrimit i UNIEL, është një program konsoliduar i këtij institucioni dhe mbështetet në këto tre shtylla:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Së pari, UNIEL, ka një përvojë të hershme në fushën e arsimit. I themeluar në vitin 1991, ky institucion ka krijuar eksperiencën e nevojshme në mësimdhënie, lidhur me programet e studimit që ofron. Fakulteti përgjegjës për këtë program studimi është themeluar në vitin 2002, ku njësia ka krijuar eksperiencën e nevojshme për hartimin dhe zhvillimin e programeve të studimit. Gjithashtu, duhet theksuar që ky program ashtu sikurse dhe programet e tjera të studimit, përmirësohen cdo vit lidhur me ndryshimet që ndodhin e kërkohen nga tregu i punës.</li><li>- Së dyti, stafi akademik, ku Departamenti i Administrimit ka në përbërje të tij 7 pedagogë efektivë, të cilët përbejnë stafin që mban përgjegjësinë për t'u angazhuar në këtë program dhe pedagogë të tjerë janë staf me kohë të pjesshme, të cilët planifikohen cdo vit akademik.</li><li>- Së treti, infrastruktura, ku Fakulteti Ekonomik ofron mjediset e nevojshme për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, në një godinë të rikonstruktuar dhe të zgjeruar në mënyrë bashkëkohore dhe me mjetet e nevojshme visuale për zhvillimin e mesimit.</li></ul> <p>Nga të dhënat që jepen në DVV, rezulton se Fakulteti i Ekonomisë për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej <b>109 pedagogë</b>, nga të cilët <b>44 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku:</p>

	<p>1 ka titullin “Profesor”, 11 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 28 kanë gradën Dr./PhD, dhe 4 Asistent Lektorë me Msc; dhe <b>65 pedagogë me kontratë (PAK)</b> nga ku 4 kanë titullin “Profesor”, 6 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 17 kanë gradën Dr./PhD. dhe 38 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa në Departamentin e Administrim Biznesit për vitin akademik 2021-2022, janë 7 lektorë, si personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët janë 1 me titullin “Profesor”, 3 me titullin “Profesor i Asociuar”, dhe 3 “Doktorë”. Në departament janë të angazhuar dhe 10 personel akademik me kontratë (PAK), nga të cilët janë 2 me titullin “Profesor”, 2 “Doktorë” dhe 6 me “Master i Shkencave”.</p> <p><i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.23 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Tabela1 dhe Tabela 2).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>UNIEL zbaton në mënyrë rigoroze ligjet e arsimit të lart në fuqi në lidhje me fushat dhe specifikat e programit të studimit. Programi Master Profesional në Administrim Biznesi funksionon në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e institucionit, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Programi i studimit që akreditohet është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Administrimit që është njësi bazë e ofrimit të tij. Të gjithë njësitë përbërëse të Fakultetit Ekonomik, punojnë në mënyrë të ngushtë me njëra tjetrën për të arritur misionin dhe objektivat e vendosura nga UNIEL. Edhe stafet akademike në këtë Fakultet punojnë ngushtësisht me njëri tjetrin në mënyrë që të arrihen objektivat e vendosura. Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi përkon me nivelin e shtatë të kornizës Shqiptare të Kualifikimit, dhe është përcaktuar në këtë mënyrë në bazë të rregulloreve dhe ligjit në fuqi.</p> <p><i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i></p>



	<i>EVIDENCA 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	<p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Administrim Biznesit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij program studimi “MPAB” është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. Bazuar në RVB dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ identifikoi këtë përputhshmëri.</p> <p><i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Institucioni ruan marrëdhëniet me studentët edhe pas përfundimit të studimve të tyre. Në bazë të takimeve në institucion, grupit të vlerësimit të jashtëm ju bë me dije se studentët e diplomuar ndiqen dhe më pas në tregun e punës.</p> <p><i>GVJ – së, nuk iu vu në dispozicion dokumentacion mbështetës për këtë, përpos listës së trajnimeve të studentëve.</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.10 Lista e trajnimit të studentëve</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion vlerëson se programi Master Profesional në Administrim Biznes në UNIEL është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. Institucioni ka kapacitetet, përvojën dhe burimet e nevojshme për ofrimin e këtij program studimi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UNIEL ka pesë fakultete në përbërjen e tij dhe siguron lirinë akademike për to, sikurse dhe mundëson lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre. Programi i studimit MP në Administrim Biznes, menaxhohet nga Departamenti i Administrim Biznesit. Departamenti ka kompetencat për programin e studimit, kompetenca si riorganizim, hapje deri në mbyllje të programit, përshtatjen dhe mbylljen e programeve të studimit. Gjithashtu, Departamenti mban përgjegjësi për menaxhimin e përmbajtjes së lëndëve, mënyrën e zhvillimit të tyre, përmirësimin dhe përshtatjen e tyre në kohë. Analiza e punës dhe ndarjes së detyrave ndërmjet personelit kryhet në cdo vit dhe pasqyrohet në analizën vjetore institucionale.</p> <p><i>EVIDENCA 1.11 Struktura organizative e UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për përmbushjen e objektivave të procesit mësimor, institucionit i nevojitet dhe mbështetje dhe bashkëpunim me aktorë të tjerë. Bashkëpunimet e institucionit me aktorë të tjerë homolog brenda dhe jashtë vendit sikurse dhe me aktorë të biznesit vendas ose të huaj, ndihmojnë në arritjen e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve. UNIEL në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion ka krijuar dhe ruajtur marrëdhënie me institucione homologe jashtë dhe brenda vendit. Gjithashtu institucioni ka marrëveshje në kuadër të programit Erasmus. Të gjitha marrëveshjet në fuqi institucioni i paraqet dhe në analizën vjetore institucionale.</p> <p><i><u>GVJ rekomandon</u> që departamenti i Administrim Biznesit duhet ta shfrytëzojnë për më shumë bashkëpunime me industrinë. Duhet ndërtuar skemat formale të bashkëpunimit me industrinë dhe duhet gjetur rrugë që mundësojnë jo vetëm punësimin e</i></p>

	<p><i>studentëve dhe praktikat/intershipet e tyre, por dhe projektet e përbashkta, mbështetjen e ideve dhe stratupeve të reja, patentim, etj.</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve.</p>	<p>Praktika mësimore është një pjesë e rëndësishme e planit mësimor të këtij program studimi. Praktika synon të lidhë studentin me tregun e punës, duke përkthyer njohuritë teorike në praktike. Për realizimin e kësaj praktike, UNIEL ka nënshkruar marrëveshje me institucione dhe kompani. Institucioni ka si qëllim të lidhë praktikën e punës me njohuritë dhe aftësitë që student ka fituar në programin e studimit. Mbikëqyrja e studentit në vendin e praktikës profesionale nuk realizohet vetëm nga udhëheqësi në vendin e punë, por dhe nga vetë institucioni.</p> <p><i>GVJ rekomandon që departamenti i Administrim Biznesit të rrisë numrin e bashkëpunimeve me industrinë në mënyrë që ti sugurojë të gjithë studentëve praktikë profesionale të lidhur me profilin që ata kanë.</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe në diskutimet e zhvilluara në institucion, u evidentua hartimi periodik i raporteve analitike të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Raportet e përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit në këtë program studimi hartohen nga Departamenti Administrim-Biznesit dhe janë pjesë e analizës vjetore të Departamentit.</p> <p><i>EVIDENCA 1.22 Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion identifikoi që UNIEL për zhvillimin e praktikave mësimore ka nënshkruar marrëveshje me institucione dhe kompani. Institucioni për realizimin e procesit mësimor sikurse dhe për zhvillime të mëtejshme akademike dhe të kërkimit shkencor ka lidhur marrëveshje me intitucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Në kuadër të bashkëpunimeve <u>GVJ rekomandon</u> që numri i tyre</i></p>


	<i>të rritet në mënyrë që të mundësohet lehtësimi i zhvillimit të praktikave të studentëve në profilin që ata kanë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës i</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit përmban lëndë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë Nr.80/2015 datë 22.07.2015 dhe me aktet nënligjore në fuqi. Programi është i organizuar në lëndë, të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe ore në auditor dhe jashtë tij sipas formave të mësidhënies. Ky program studimi gjithësej ka në total 60 kredite, me kohëzgjatje prej dy vitesh akademike. Ngarkesa e vitit akademik ndahet në 360 orë leksione dhe 240 orë seminare. Programi i studimit MPAB ofron një gamë të gjerë njohurish në kategorinë e lëndëve të formimit të përgjithshëm sipas legjislacionit në fuqi dhe lëndët kategorizohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- A-Lëndë bazë: (5 kredite), 8.3%</li> <li>- B-Lëndë karakterizuese: (23 kredite), 38.3%</li> <li>- C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: (16 kredite), 26.7%</li> <li>- D-Lëndë plotësuese: (6 kredite), 10%</li> <li>- E-Detyrime përmbyllese: (10 kredite), 16.7 %</li> </ul>


	<p>Organizimi i lëndëve dhe veprimtarive në këtë program studimi janë në përputhje me legjislacionin dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij - Plani mësimor Master Profesional në Administrim Biznes 2021 -2022 pjesë e dosjes së programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programet e lëndëve të këtij programi studimi janë hartuar me qëllimin që studenti të fitojë njohuri të thelluara dhe me gamë të gjerë në fushën e administrimit të biznesit. Ato janë të ndara sipas tipit të veprimtarisë A-E, duke mundësuar kështu që përveç formimit në administrim biznesi të ketë mundësi që të krijojë një formim specifik në vartësi të dëshirave dhe rrethanave që i paraqitet secilit student. Programi Master Profesional në Administrim Biznes profilizon studentët në fusha të ndryshme të administrimit të biznesit si: manaxhim strategjik i biznesit; manaxhim i operacioneve të bizneseve prodhuese apo të shërbimit; manaxhimin e sjelljes në organizatat e biznesit, qeverisjen e duhur të korporatave dhe marrjen e vendimeve të duhura manaxheriale. Programi dhe lëndët që ai ka, kanë si qëllim përgatitjen e drejtuesve, specialistëve apo pjesëtarëve të stafeve të kompanive private, të institucioneve shtetërore apo organizatave jofitimprurëse me një orientim të caktuar.</p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit.</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e studimeve në UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.16 Studim (periodik) për tregun e punës pas daljes së studenteve</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.17 Harta e punësimit të studenteve të programit të studimit të ciklit të dytë: Master Profesional në Administrim Biznes</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, programi i studimit Master Profesional në "Administrim Biznes" ka të përcaktuar dhe kategorizuar lëndët përbërëse sipas kategorive. Praktika mësimore është pjesë e këtij program studimi dhe qëndron në kategorinë D-Lëndë plotësuese dhe ka 6 kredite, të cilat përkthehen në 10% të krediteve totale të programit MPAB. Studentët sipas planit mësimor të masterit profesional "Administrim Biznes" dhe strukturës mësimore, e zhvillojnë praktikën profesionale në semestrin e dytë të vitit të parë akademik. Kohëzgjatja e praktikës mësimore është e përcaktuar në programin e studimit dhe i bëhet me dije më parë studentëve.</p>

	<p>Ngarkesa e në orë e praktikës mësimore është 150 orë jashtë auditorit. Programi i studimit MPAB ka pjesë të tij dhe detyrimet përmbyllëse të cilat janë në formën e provimit të formimit ose të punimit të diplomës. Ngarkesa e detyrimeve përmbyllëse është 10 kredite dhe përfaqëson 16.7% të krediteve të këtij program. Detyrimet përmbyllëse të shprehura në orë janë 250 orë studimi individual.</p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e studimeve në UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit.</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij - Plani mësimor Master Profesional në Administrim Biznes 2021 -2022 pjesë e dosjes së programit të studimit.</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program.</p>

<p>mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Kriteri 6 aplikohet për institucionet e arsimit të lartë me status të vecantë dhe nuk aplikohet për këtë institucion.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Ky program studimi ‘Master Profesional’ në ‘Administrim Biznes’ është i vetmi program studimi master profesional që ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit.</p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e studimeve në UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit.</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij - Plani mësimor Master Profesional në Administrim Biznes 2021 -2022 pjesë e dosjes së programit të studimit.</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP ne AB)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni identifikoi që programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Të gjitha lëndët e këtij program studimi janë të kodifikuara.</p> <p><i>EVIDENCA 1.9 Pasqyrimi i kodifikimit te lendeve te programit te studimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të</p>	<p>Programi i studimit të këtij cikli studimi ‘Master Profesional’ në ‘Administrim Biznes’ është program që zhvillohet vetëm nga UNIEL dhe nuk është program i përbashkët e ndonjë institucion tjetër brenda apo jashtë vendit.</p>

lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ evidentoi që programi i studimit MPAB është ndërtuar bazuar në legjislacionin në fuqi. Ky program ka të kategorizuar dhe vlerësuar lëndët në kredite, të cilat janë përcaktuar në përputhje me legjislacionin dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>UE është akredituar me Vendimin Nr 49 të vitit 2020 të Bordit të Akreditimit për 6 vite. Fakulteti Ekonomik është një nga 5 fakultetet e UE hapur me VKM Nr, 307 të vitit 2002.</p> <p>Fakulteti Ekonomik i Universiteti “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit ka në përbërje të tij, 6 njësi si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamentin e Administrim Biznesit;</li> <li>2. Departamentin e Marketingut dhe Inxhinierisë;</li> <li>3. Departamentin e Financë – Kontabilitetit</li> <li>4. Departamentin e Ekonomiksit</li> <li>5. Departamentin e së Drejtës</li> <li>6. Qendrën Kërkimore Shkencore për Kërkime dhe Zhvillime në Drejtësi dhe Ekonomi</li> </ol> <p><i>Referuar tabelës 1 të RVB paraqitet numri i personelit për çdo njësi bazë të FEUE, ku evidentohet që të 6 njësitë kanë në përbërje 7 PAE duke plotësuar kriterin ligjor në lidhje me numrin.</i></p> <p><i>Referuar tabelës 2 të RVB evidentohet që Departamenti AB ka 7 PAE (duke plotësuar kriteret ligjore) nga të cilët:</i></p>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria profesor - 4 (1 Prof.Dr. dhe 3 Prof.Asoc.Dr</li> <li>- Kategoria Doktor Shkencash - 3</li> </ul> <p>dhe 10 PAK, nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria profesor - 2</li> <li>- Kategoria Doktor Shkencash - 2</li> <li>- Kategoria Doktor në process – 1</li> <li>- Kategoria Msc - 5</li> </ul> <p>Në programin e studimit MPAB, sipas Tabelës 6 në RVB për vitin 2021-2022 evidentohet të angazhohen 7 PAE / 3 PAK , pra në raportin 70% PAE dhe 30 % PAK/.</p> <p><i>EVIDENCA 1.23 Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.24 Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin studimit Master Profesional në Administrim Biznes.</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.25 Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse.</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin 2021-2022.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në intitucion, GVJ evidentoj se njësia bazë përmbush kërkesat e programit me personel ndihmës akademik dhe administrativ sipas nevojave që ka. Programi i studimit nuk kryen praktika laboratorike sepse parashikon vetëm praktikë mësimore pranë institucioneve ose bizneseve private.</p> <p><i>EVIDENCA 1.20 Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj dhe për praktikën profesionale.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe</p>	<p>Në zbatim të akteve rregullatore dhe me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë, FE ka caktuar një koordinitor që kujdeset për realizimin e misionit dhe veprimtarinë e gjithanshme të këtyre programi. Përgjegjësi i programit koordinon dhe monitoron mbarëvajtjen e zhvillimit të mësimi si edhe kujdeset për ruajtjen e cilësisë dhe disiplinës të zhvillimit të mësimi në programin e studimit. Koordinatori është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin edhe për praktikat profesionale duke u angazhuar për arritjen e objektivave të programit.</p>

praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<i>EVIDENCA 2.15 Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit; Detyrat e koordinatorit të programit.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe vizitës në institucion, GVJ evidentoi që njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore në lidhje me stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrative.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>GVJ evidentoi se Fakulteti Ekonomik dhe Departamenti i Administrim Biznesit vënë në dispozicion të gjithë informacionet për programin e studimit organizimin dhe strukturën që programi ka. Studentët aktual dhe potencial mund të identifikojnë lehtësisht të gjithë të dhënat e këtij programi nëpërmjet syllabuseve të lëndëve sikurse dhe në faqen e internetit të UE. Në planin mësimor përcaktohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëndët e programit sipas kategorive</li> <li>• Orët për secilën lëndë, të ndara në seminare, leksione dhe orë individuale</li> <li>• Raporti i orëve Leksion/Seminar</li> <li>• Kreditet e lëndëve</li> </ul> <p>Gjatë vizitës në institucion studentët na informuan që të gjithë informacionin e nevojshme në lidhje me programin e studimit dhe lëndët i marrin nëpërmjet syllabuseve të lëndëve, sistemit të manaxhimit të informacionit EMS dhe faqes zyrtare të UE.</p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP neAB)</i>  <i>EVIDENCA 4.5 Tabela treguese e anagzimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022 (lëndët si dhe ngarkesa përkatëse)</i></p>

	<p><i>EVIDENCA 1.25 Të dhena Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.1 Guida e pedagogut mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësues, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznes përmban planin mësues i përfshin informacionin e nevojshëm për ndarjen semestrale të lëndëve, ngarkesën mësimore të lëndëve të përkthyer në orë brenda dhe jashtë auditorit. Plani është hartuar nga departamenti përgjegjës për planin mësues dhe i firmosur nga përgjegjësi i departamentit dhe Dekani dhe i miratuar nga senati akademik dhe Rektori.</p> <p>Në planin mësues të këtij program studimi paraqiten elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emertimi i lëndëve/moduleve të programit të studimit sipas semestrave</li> <li>• Numrin e krediteve për cdo lëndë/modul dhe raportin e orëve (leksione dhe seminare)</li> <li>• Detyrimet sipas moduleve (seminare, ushtrime, projekte kursi, detyra kursi etj)</li> <li>• Mënyra e kontrollit të dijeve të cdo lëndë/moduli (semestri, provim ose provim i ndërmjetëm)</li> </ul> <p>GVJ evidentoi që UNIEL disponon dhe shpërndan informacionin për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.5 Tabela treguese e anagzhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022 (lëndët si dhe ngarkesa përkatëse)</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.25 Të dhena Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.1 Guida e pedagogut mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me</p>	<p>Programi i studimit bazuar në rregullore kanë të shpallura të gjitha informacionet për studentët që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studentëve. Në këtë program studimi kanë të drejtë të aplikojnë individë që kanë</p>




<p>kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>përfunduar një program studimi dhe kanë një diplomë universitare Bachelor në systemin me kohë të plotë ose të pjesshme dhe plotësojnë këto kriteret:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kriterin e meritës (nota mesatare e ponderuar e studimeve në studimet e ciklit të parë bachelor).</li> <li>• kriterit e rëndësisë (koeficienti i profilit të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programin e studimit të DAB-së).</li> <li>• Kuotave të paracaktuara nga DAB.</li> </ul> <p>Departamenti i Administrim Biznesit ofron gjithashtu dhe njohjen dhe transferimin e krediteve midis programeve të të njëjtit cikël. Departamenti gjithashtu bën të mundur dhe ekuivalentimin e programeve në mënyrë të pjesshme apo të plotë, e përcaktuar kjo dhe në statutin e UNIEL.</p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementet përberës të tij. (Vendim, Departamentit të Administrim Biznesit "Mbi kriteret e shpalljes fitues të aplikantëve për programet e ciklit të dytë Master i Shkencave në Menaxhim dhe Master Profesional në Administrim Biznes, për vitin akademik 2021-2022"</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.30 Formatit i dosjes personale të stafit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, përkatësisht syllabuset e lëndëve, GVJ konstatoi se në përgjithësi në syllabusin e cdo lënde paraqitet informacion i detajuar. Formatit i syllabusit është i përcaktuar sipas një formati të gjithëpranuar. GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar.</p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.24 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit Master Profesional në Administrim Biznes.</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.5 Tabela treguese e anagzhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022 (lëndët si dhe ngarkesa përkatëse)</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.1 Guida e pedagogut mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.13 Të dhëna mbi publikimin në faqen Eëb.</i></p>

	<i>EVIOENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementet përbërës të tij</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	GVJ nga intervistat gjatë takimeve dhe nga RVB, konstatoi se programi lëndor (syllabet) diskutohen në fillim të cdo viti akademik dhe dokumentacioni firmoset nga titullari i lëndës dhe përgjegjësi i departamentit. Përmirësimet dhe ndryshimesh të syllabuseve duhet të bazohen në rregullore. Sipas kësaj rregulloreje ndryshimet propozohen nga Departamenti, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me ekspertë të fushës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. Ndryshimet e syllabuseve lidhen me përditësim dhe rifreskim të tyre bazuar në informacionet dhe zhvillimet e fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit.  <i>Evidenca 2.16 Përshkrim i programit të studimit të ciklit të dyte Master Profesional në Administrim Biznes</i>  <i>Evidenca 2.17 Procedura për ndryshimin e kurrikules</i>  <i>Evidenca 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ evidentoi bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitës në institucion që program i studimit MPAB është informues dhe i detajuar. Për programin mësimor dhe përmbajtjen e tij njoftohen dhe studentët nëpërmjet formave elektronike dhe fizike.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

#### Standardi II.4


**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë,	Nga shqyrtimi i dosjes se programit, konstatojmë se emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, janë ndërtuar të tilla që ofrojnë njohuri në fushat e Administrim biznesit dhe të mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive për studime të

<p>thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. Bazuar në vizitën në institucion konstatuam që zhvillimi i mësimin në këtë program është në funksion të rritjes së interaktivitetit ndërmjet pedagogut dhe studentëve, që mundëson rritjen e njohurive dhe simulimin e mendimit kritik. GVJ është i mendimit që kurrikula e programit të studimit në përgjithësi është një kurrikul që i përgjigjet qëllimit dhe objektivave të programit të studimit.</p> <p><i>EVIDENCA 5.7 Të dhëna rmbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.18 ALUMNI</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.19 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota rnesatare në hyrje dhe në dalje</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.1 Guida e pedagogut Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Program i studimit Master Profesional në "Administrim Biznes" është i organizuar për t' i dhënë studentëve njohuritë e nevojshme që t' u krijohet mundësia për t' u punësuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë në vend. Ndarja në kredite sipas veprimtarive janë në harmoni me ligjet dhe VKM në fuqi. Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Biznesi siguron një shpërndarje të tillë të lëndëve mësimore:</p> <p>A-Lëndë bazë: (5 kredite), 8.3% - Ku ligji detyron 5%-10%</p> <p>B-Lëndë karakterizuese: (23 kredite), 38.3% - Ku ligji detyron 30%-40%</p> <p>C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: (16 kredite), 26.7% - Ku ligji detyron 20%-30%</p> <p>D-Lëndë plotësuese: (6 kredite), 10% - Ku ligji detyron 10%</p> <p>E-Detyrime përmblylles: (10 kredite), 16.7 %- Ku ligji detyron 10%-20%</p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.18 ALUMNI</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.19 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota rnesatare në hyrje dhe në dalje</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.7 Të dhëna rmbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021</i></p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi si dhe me profilin e programit. GVJ vlerëson se ngarkesa në kredite bazuar në veprimtaritë e lëndëve është e bazuar në ligjin në fuqi Shtojca nr 1 në vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019.</p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.5 Tabela treguese e anagzhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022 (lëndët si dhe ngarkesa përkatëse)</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.25 Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në programin e studimit Master Profesional në Administrim Biznesi ndarjet ndërmjet formimit teorik dhe praktik janë realizuar për të mundësuar arritjen e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në Administrim Biznesi siguron një shpërndarje të tillë të lëndëve mësimore sipas veprimtarive:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. A-Lëndë bazë: (5 kredite), 8.3% - Ku ligji detyron 5%-10%</li> <li>2. B-Lëndë karakterizuese: (23 kredite), 38.3% - Ku ligji detyron 30%-40%</li> <li>3. C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: (16 kredite), 26.7% - Ku ligji detyron 20%-30%</li> <li>4. D-Lëndë plotësuese: (6 kredite), 10% - Ku ligji detyron 10%</li> <li>5. E-Detyrime përmbyllese: (10 kredite), 16.7 %- Ku ligji detyron 10%-20%</li> </ol> <p><i>Evidenca 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p>

	<p><i>EVIDENCA 1.24 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit Master Profesional në Administrim Biznes.</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.23 Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.5 Tabela treguese e anagzimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022 (lëndët si dhe ngarkesa përkatëse</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit në dispozicion konstatoi se Syllabuset e lëndëve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme. Përditësimet vijnë si pasojë e kërkesave të tregut dhe gjithashtu nga opinionet e lektorëve dhe studentëve të degës së studimit. Të gjitha ndryshimet bazohen dhe respektojnë ligjet në fuqi dhe përmbajnë të gjithë elementët e detyrueshëm të syllabuseve.</p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.5 Tabela treguese e anagzimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022 (lëndët si dhe ngarkesa përkatëse</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.1 Guida e pedagogut ësimi online nëpërmjet Microsoft Teams</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të Master Profesional në Administrim Biznes është e ndërtuar në mënyrë që të garantojë përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për studentët. Përmbajtja e këtij program thëllon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Programi i MPAB thëllon njohuritë e marra në ciklin e parë të studimeve duke zhvilluar lëndë kryesive të profilit të Administrim Biznesit në vitin akademik. Programi përmban këto lëndë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) Administrim Publik</li> <li>b) Marrje Vendimesh Menaxheriale</li> <li>c) Aftësi Menaxheriale</li> <li>d) Lidërshipi</li> <li>e) Menaxhim Cilësisë Totale</li> <li>f) Sjellje Organizative e Avancuar</li> <li>g) Biznes Ndërkombëtar</li> <li>h) Menaxhim Projekti</li> <li>i) Menaxhimi Shpërblimit</li> <li>j) Detyrime përmblylëse-Praktikë profesionale dhe Temë diplome ose Provim Formimi.</li> </ol> <p>Bazuar në syllabuset e lëndëve GVJ evidentoi që objektivat e lëndëve përputhen dhe përbëjnë objektivat e programit për të siguruar përfitimin e dijeve dhe kompetencave manaxheriale.</p>







	<p><i>EVIDENCA 2.16 Përshkrim i programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Administrim Biznes</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.16 Studimi (periodik) për tregun e punës pas daljes së studenteve</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.17 Harta e punësimit të studentëve të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Administrim Biznes</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.7 Të dhëna mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021.</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.18 ALUMNI</i></p>
<p><b>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</b></p>	<p>GVJ kostaton në bazë të dokumentave se sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale, por edhe punësimin e tyre direkt në përputhje me kërkesat e tregut.</p> <p>Bazuar në përmbajtjen e programit njohuritë e marra në këtë program studimi mundësojnë profilizimin e studentët në fusha të ndryshme të administrimit të biznesit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• manaxhimit të duhur të sjelljes organizative në organizatat e biznesit;</li> <li>• marrjen e duhur të vendimeve manaxheriale</li> <li>• manaxhimit të cilësisë etj.</li> </ul> <p>Profilizimet i mundësojnë studentëve të punësohen në nivele të ndryshme të hierarkisë manaxheriale dhe në kompani dhe organizata të ndryshme. Bazuar në dokumentacion mundësitë e punësimit të studentëve fillohen nga marrëveshjet që UE ka me institucionet e ndryshme dhe vazhdojnë më tej në tregun e punës. Bazuar në legjislacion ky program i ciklit të dytë të studimeve nuk i jep mundësinë studentëve për zhvillim të mëtejshëm akademik dhe për vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve</p> <p><i>EVIDENCA 1.16 Studimi (periodik) për tregun e punës pas daljes së studentëve</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.17 Harta e punësimit të studentëve të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Administrim Biznes</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.7 Të dhëna mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.10 Lista e trajnimit të studentëve</i></p>




	<i>EVIDENCA I.20 Marëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj dhe për praktikën profesionale</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ evidentoi bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitës në institucion që program i studimit MPAB garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Gjithashtu programi është i ndërtuar dhe ndryshon për ty përshtatur me tregun e punës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Bazuar në vizitën e bërë në institucion dhe komunikimin me instancat drejtuese, për përmirësimin e programit të studimit departamenti si njësi bazë drejtuese zhvillon takime me institucionet që ka bashkëpunim, intervista dheurvejime me studentë e staf akademik.</p> <p>Bazuar në vizitën në institucion GVJ identifikoi që një nga mënyrat më efektive të përmirësimit të programit dhe përshtatjen e tij me tregun e punës zhvillohen nëpërmjet komunikimit dhe intervistat e zhvilluara me institucionet partnere. Këto institucione janë më pranë tregut të punës dhe mundësojnë propozime efektive për ndryshimet e vetë tregut që indukojnë dhe ndryshimet apo përmirësimet e programit. Në intervistat në institucion, GVJ-ës iu komunikua se në lëndë të ndryshme, pjesë përbërëse të kurrikulës së programit, përfshiheshin raste studimore të cilat vijnë nga aktorë të ndryshëm dhe përmirësohen cdo vit.</p> <p>E gjithë kjo përkthehet në mundësi dhe oportunitet për përmirësim bazuar në kërkesat e tregut dhe të gjithë stakeholdersat e përfshirë në proces.</p>


	<p><i>Evidenca 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.16 Përshkrim i programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Administrim Biznes</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.16 Studimi (periodik) për tregun e punës pas daljes së studentëve</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.17 Harta e punësimit të studentëve të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Administrim Biznes</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.7 Të dhëna mbipunësimit e të diplomuarve 2020-2021.</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.18 ALUMNI</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre. Studentët janë të përfaqësuar dhe angazhuar në Senatit Akademik UNIEL dhe janë të organizuar në Këshillin Studentor. Kjo njësi ka rregulloren e organizimit dhe funksionimit. Këto njësi janë gjatë gjithë kohës në bashkëpunim me departamentin për përmirësimin e programit të studimit dhe jo vetëm. Mendimet dhe opinionet e tyre merren parasysh dhe diskutohen për të aritur rezultatet e dëshiruara. Gjithashtu departamenti konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar nëpërmjet ALUMNI për cdo përmirësim të mundshëm dhe opinion që japin këta aktorë.</p> <p><i>EVIDENCA 2.1 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.2 Rregullore e Këshillit Studentor</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.7 Të dhëna mbipunësimit e të diplomuarve 2020-2021.</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.18 ALUMNI</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe</p>	<p>UNIEL ka një rrjet bashkëpunëtorësh me të cilët bashkëpunon edhe për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit. Përditësimi i vazhdueshëm dhe riorganizimi bëhet në përputhje me vizionin strategji të zhvillimit të ekonomisë shqiptare dhe prioritetet e zhvillimit të vendit.</p> <p><i>EVIDENCA 1:14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.10 Lista e trajnimit të studentëve</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.20 Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj dhe për praktiken profesionale</i></p>

institucione publike e private.	<p><i>EVIDENCA 4.6 Lista e aktiviteteteve te Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.17 Procedura për ndryshimin e kurrikulës</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.16 Studimi (periodik) për tregun e punës pas daljes së studentëve</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ bazuar në vizitën në institucion sikurse dhe në dokumentacionet e vëna në dispozicion evedintoi gadishmërinë e institucionit për përmirësimin e programit të studimit. Këto përmirësime programi vijnë nga bashkëpunimet që institucioni ka me aktorë të fushës dhe institucione të tjera homologe. Gjithashtu evidentohet gadishmëria e institucionit për gjithëpërfshirje të palëve në diskutimet për përmirësime.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në planin Strategjik të zhvillimit të programit, njësia përgjegjëse për ofrimin e programit, përcakton qartësisht objektivat dhe qëllimet e programit që lidhen me aftësimin e studentëve dhe rolin që ata do të kenë në tregun e punës. Këto objektiva dhe qëllime janë në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ gjykon që prioritetet e programit kanë të bëjnë me kalimin e suksesshëm të studentëve në tregun e punës sikurse dhe ndjekjen dhe mbështetjen e tyre në këtë treg. Programi ka qëllim të tij parësor tregun e punës dhe më pak kërkimin shkencor. Ky program është zhvilluar për të përgatitur specialistë në fushat praktike të administrimit të biznesit në biznese apo entitete private dhe/ose publike. Programi dhe plani mësimor është konceptuar për të mundësuar studentëve formësim teorik dhe praktik për të qënë të gatshëm për tregun e punës në përfundim të ciklit të studimit.</p> <p><i>EVIDENCA 1.16 Studimi (periodik) për tregun e punës pas daljes së studentëve</i></p>

	<p><i>EVIDENCA 1.20 Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj dhe për praktiken profesionale</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.6 Plani strategjik për zhvillimin e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Njësia kryesore është përgjegjëse për administrimin e veprimtarive shkencore dhe mësimdhënies. Bazuar në rregulloren e institucionit identifikojmë që Fakulteti Ekonomik, dhe departamenti i Administrim Biznesit përgjegjës për këtë program studimi janë ato që nxisin dhe bashkërendisin veprimtaritë e këtij program duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e studimit. Fakulteti Ekonomik organizon konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe nxit pjesëmarrjen e personelit akademik të institucionit përfshirë dhe ato të departamentit të Administrim Biznesit për pjesëmarrje në këto konferenca.</p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Në këtë program studimi, studentët nxiten dhe motivohen për tu angazhuar në studime dhe projekte kërkimore. Syllabuset e lëndëve të këtij program kanë të përfshirë detyra kursi dhe projekte individuale dhe në grup. Në këto detyra dhe projekte studentët nxiten dhe angazhohen për të zhvilluar punë studentore kërkimore. Për të ndihmuar studentët institucioni ka krijuar aksesin në biblioteka onlinë dhe në bibliotekën e institucionit.</p> <p><b>Për të rritur mundësitë e angazhimit të studentëve në punë kërkimore GVJ sygjeron që institucioni të zhvillojë në të ardhmen dhe konferenca studentore.</b></p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit</i> <i>EVIDENCA 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022</i> <i>EVIDENCA 2.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library</i> <i>EVIDENCA 3.15 Konferencat shkencore të UNIEL në bashkëpunim IAL</i> <i>EVIDENCA 3.16 Buletinë shkencorë UNIEL dhe FE etj</i> <i>EVIDENCA 3.19 Konferenca e 9-të shkencore FE 2021 etj.</i></p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>GVJ bazuar në takimet në institucion evidentoi që institucioni mbështet financiarisht aktivitet kërkimore shkencore të stafëve akademike dhe aktivitetet studentore. Gjithashtu institucioni administron të ardhurat e gjeneruara nga aktivitetet e ndryshme. Aktivitetet studentore që financohen nga institucioni janë ekspeditat studentore dhe publikimet në revistën periodike, ndërsa për stafet akademike financohen nga institucioni publikimet dhe organizimi i konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu institucioni mundëson përdorimin e bibliotekave online dhe Bibliotekën e institucionit, për studentët dhe stafin akademik pa pagesë.</p> <p><i>EVIDENCA 2.3 Miratimi i Buxhetit 2021 dhe Buxhetit 2022</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.4 Realizimi i ekspeditave studentore për vitin akademik 2021-2022</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library</i></p> <p><i>EVIDENCA 2,8 Fondi i Libri</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Objektivat dhe qëllimet e programit të studimit MPAB janë në përputhje të plotë me objektivat e institucionit duke garantuar orientimin e studentëve në fushat praktike por dhe ato të kërkimit shkencor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.7</b></p>	
<p><b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin</p>	<p>Njësia përgjegjëse për këtë program studimi mbështet projektet e reja kërkimore shkencore dhe siguron bashkëpunim me aktorë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për realizimin e një kërkimi shkencor efektiv. Realizimi i konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare është një shëmbull i mirë i bashkëpunimit me</p>

<p>me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>aktorë të tjerë për avancimin e kërkimit shkencor në institucion dhe për arritjen e objektivave të programit të studimit.</p> <p><i>EVIDENCA 3.15 Konferencat shkencore të UNIEL në bashkëpunim IAL</i>  <i>EVIDENCA 3.16 Buletinë shkencorë UNIEL dhe FE etj</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.18 Publikimi i të dhënave, studimeve, njoftimeve në Buletinin shkencor UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.19 Konferenca e 9-të shkencore FE 2021 etj.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Institucioni bazuar në RVB angazhohet për tu përgjigjur kërkesave për analiza, studimeve dhe projekteve me karakter kërkimor shkencor me anë të stafit akademik dhe studentëve. Një nga evidencat e këtyre angazhimeve janë dhe mobilitetet dhe marrëveshjet e bashkëpunimit ERASMUS.</p> <p><b>GVJ nuk evidentoi kërkesa nga bashkëpunëtorët dhe aktorët biznese.</b></p> <p><i>EVIDENCA 2.21 Bashkëpunimi ndërkombetar (njoftime për mobilitete), EVIDENCA 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+, EVIDENCA 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personelit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>GVJ evidentoi bazuar në dokumenacionin e vënë në dispozicion që institucioni zhvillon konferenca dhe aktivitete të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët në arritjen e objektivave. Janë zhvilluar disa konferenca në institucion të cilat janë me bazë fakulteti, institucioni si dhe konferenca me pjesëmarrje aktive të studentëve.</p> <p><i>EVIDENCA 3.15 Konferencat shkencore të UNIEL në bashkëpunim IAL</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.19 Konferenca e 9-të shkencore FE 2021 etj.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Studentët në këtë program studimi kanë mundësinë të thellojnë njohuritë e tyre në fushat e menaxhimit. Ky thellim i njohurive bën të mundur përgatitjen e studentëve për të qënë konkurrues në tregun e punës. Programi i studimit azhrohohet bazuar në kërkesën e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, dhe kjo mundëson kalimin e lehtë të studentëve në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>EVIDENCA 1.16 Studimi (periodik) për tregun e punës pas daljes së studentëve</i></p>




	<p><i>EVIDENCA 1.17 Harta e punësimit të studentëve të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Administrim Biznes</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.20 Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj dhe për praktikën profesionale.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Të diplomuarit në këtë program studimi nuk ushtrojnë profesione të rregulluara.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për proramën e studimit Master Profesional në Administrim Biznes.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion evidencoi që programi i studimit MPAB mundëson dhe garanton thellimin e njohurive në fushat e administrimit të biznesit. Ky program garanton formimin e profesionistëve të cilët do të jenë pjesë e tregut kombëtar ashtu sikurse dhe të atij ndërkombëtar.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
---	--	-------------------------------------	------------------------------------	-------------------------------------




				X
--	--	--	--	---

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në programin mësimor Master Profesional në Adminsimir Biznesi, format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, detyra kursi, praktikat profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. Këto forma janë në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Orët e mësimimit organizohen duke iu pershtatur natyrës së lëndëve me qëllim angazhimin e të gjithë studenteve në funksion të një mësimnxënie efikase. Kjo mënyrë interaktive nxit interesin tek studentët duke i krijuar liri veprimi dhe mendimi. Kjo mënyrë interaktive mundëson jo vetëm rezultate në të nxënë por rrit dhe mundësinë e përkthimit të performancës në një rezultat të suksesshëm në vlerësimin e lëndës. Në procesin mësimor janë aplikuar edhe ftesa për personal akademik të jashtëm apo për personalitete të fushës të cilët kanë ofruar leksione të hapura dhe kanë sjellë në auditor eksperiencat e tyre apo të institucionave që kanë drejtuar.</p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përberës të tij</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.24 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit Master Profesional në Administrim Biznes</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p><i>EVIDENCA 1.30 Formati i Dosjes personale të stafit</i></p> <p>Bazuar në RVB dhe nga informacionet e grumbulluara në takimet me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit, rezultoi se, stafi akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke përshtatur dhe ofruar mundësi dhe forma alternative të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijes. Nga bashkëbisedimi me studentët u konstatua se përveç leksioneve, gjatë seminareve krahas kontrollit të njohurive nëpërmjet pyetjeve/përgjigjeve dhe diskutimeve, aplikohen edhe raste studimore e detyrat individuale me studentët. Natyra specifike e këtij program studimi kërkon përdorimin dhe aplikimin e metodave të larmishme të mësimdhënies nëpërmjet kompjuterave dhe sistemit të rrjeteve të internetit. Gjithashtu stafi i këtij program studimi mundëson për studentët konsultime javore sipas axhendave të paracaktuara për të mundësuar qartësimin dhe ndihmën e nevojshme për to. Gjithashtu, studentët e programit MPAB përfshihen dhe në aktivitete të tjera, si konkurse apo dhe leksione të hapura me të ftuar në auditor nga bota e biznesit dhe profesorë vendas apo dhe të huaj.</p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.30 Formati i Dosjes personale të stafit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.29 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UNIEL mundëson përdorimin e metodave fleksibël pedagogjike për të arritur rezultatet e pritshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Stafi pedagogjik për arritjen e kësaj pritshmërie është pjesë e trajnimeve në kuadër të programit Erasmus. Stafi akademik gjithashtu ka mundësi të përdorë mjete bashkëkohore të mësimdhënies siç janë mjetet audio-vizive. Gjithashtu përmirësimi i kompetencave zhvillohet dhe nga lektorë të ftuar dhe ekspertë të fushës.</p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.30 Formati i Dosjes personale të stafit</i></p>

	<p><i>EVIDENCA 2.21 Bashkëpunimi ndërkombetar (njoftime për mobilitete), EVIDENCA 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+, EVIDENCA 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personelit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar nga studentët, gjatë vizitës në institucion si dhe referuar CV-ve, fushave të ekspertizës dhe eksperiencës së stafit, rezultoi se stafi akademik është kompetent në shpjegimin e koncepteve dhe transmetimin e njohurive, nëpërmjet përdorimit të metodave të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit përkatës. Në kontrollin rastësor që GVJ kreu në dosjet e stafit akademik, rezultoi që stafi është kompetent dhe ka një përputhje të profilit të lëndës dhe ekspertizës së pedagogut përkatës. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, përbëhet nga :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 Prof.Dr</li> <li>- 3 Prof.Asoc</li> <li>- 3 Dr</li> </ul> <p>Të gjithë anëtarët e stafit akademik janë të aftë të përdorin mjetet teknologjike përgjatë zhvillimit të mësimin.</p> <p><i>EVIDENCA 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturen e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementet përberës të tij. (Vendim, Departamentit të Administrim Biznesit "Mbi kriteret e shpalljes fitues të aplikantëve për programet e ciklit të dytë Master i Shkencave në Menaxhim dhe Master Profesional në Administrim Biznes, për vitin akademik 2021-2022"</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.30 Formati i dosjes personale të stafit</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.9 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe</p>	<p>UNIEL i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Institucioni periodikisht vlerëson format dhe metodat e mësimdhënies, me qëllim përmirësimin e këtyre metodave në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, duke përfshirë edhe studentët. Studentet i shprehin shqetësimet dhe sugjerimet e tyre nëpërmjet pyetsorëve semestralë të cilat administrohen dhe analizohen nga departamenti dhe NJSBC. Këto</p>




<p>duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>rezultate të vlerësuara shërbejnë si pikënisje për vitin e ardhshëm akademik, për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe përfshirjes së studentëve në proces. Për të siguruar ofrimin e mësimdhënies së duhur institucioni ka zhvilluar një procedurë shumë rigorozë për afrimin e stafit të ri akademik, ku kriteret e vendosura duhet të përmbushen dhe zhvillohet dhe analiza e profilit dhe kompetencave nga Departamenti.</p> <p><i>EVIDENCA 1.30 Format i dosjes personale të stafit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.26 CV e stafit akademik të programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e Fakultetit, GVJ evidentoi që institucioni ka struktura të cilat promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të mësimdhënies dhe inkurajojnë zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies. Njësia përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë është NJSBC së bashku me vlerësuesit e jashtëm. Institucioni bazuar në RVB dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion përfshin studentët dhe stafin akademik në vlerësim dhe përdor një sërë metodash të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta. Ndër metodat e përdorura që shërbejnë si instrumente të vlerësimit të cilësisë të cilat ishin të dokumentuara në institucion dhe pjesë përbërëse të raporteve të monitorimit të cilat ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikules, të të mësuarit</li> <li>• Intervista me studentët</li> <li>• Punime kërkimore të personelit akademik lidhur me cilësinë e mësimdhënies</li> <li>• Dëgjime në auditor</li> <li>• Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë</li> <li>• Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare e provimet për module</li> <li>• Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e projekteve/detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit etj</li> </ul>

	<p>Nga vizita në institucion mësuam se personeli akademik përpiqet që të angazhojë studentët me diskutime brenda fushës së lëndës apo të realizojnë konkurse dhe vizita studimore, për ta bërë më tërheqëse orën e mësimit, të përdorë case study, apo të përfshijë raste nga tregu lokal.</p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ bazuar në vizitën në institucion evidentoi që praktikrat e përdorura për mësimdhënie dhe mësimxënie kanë në qendër studentitn. Këto praktika janë në përmirësim të vazhdueshëm bazuar në rezultatet dhe rekomandimet e marra në forma të ndryshme brenda institucionit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ, nga dokumentacioni i depozituar nga institucioni konstatoi se, mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, përcaktohen në rregullore të posaçme siç janë rregullorja e UNIEL, rregullorja e fakultetit, rregullorja e programit të studimit si dhe rregullorja e provimeve. Në këto rregullore parashikohen të gjitha elementet e procesit të vlerësimit si detyra shtëpie, detyra kursi, punë në grup, provimi i parë dhe provimi i dytë. Njohja e studentëve me këto rregullore shihet si një e drejtë dhe detyrim i tyre dhe janë pjesë përbërëse e kontratës së shkollës dhe studentit. Vlerësimi i studenteve realizohet nëpërmjet sistemit të pikëve 0-100, të cilat konvertohen në nota (4-10). Mënyra e vlerësimit është:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare vlerësohen me 11.5%,</li> <li>• plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit/projekteve) me 12.5%,</li> <li>• kolegiumet me 26%</li> <li>• provimi perfundimtar, i cili vlerësohet me 50%.</li> </ul> <p>Provimet në UNIEL zhvillohen nga lektorët e lëndës dhe janë pjesë e një procdi të standartizuar korigjimi. UNIEL në bazë të marrëveshjes me AADF zhvillon dhe provimet në bazë të projektit CleanScore, ku korigjimi është me sistem të automatizuar duke mos lënë hapsira për interpretim rezultatesh. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve</p> <p><i>EVIDENCA 3.4 Marrëveshja për implementimin e CLEANSCORE</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion dhe në RVB, GVJ konstatoi se në javën e parë të cdo semestri gjatë prezantimit të programit bëhet dhe prezantimi i metodologjisë së vlerësimit të njohurive duke e arsyetuar dhe shpjeguar këtë metodologji. Me anë të këtij prezantimi studentët njohin detyrimet e tyre dhe kohën e përmbushjes së këture detyrimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Format e kontrollit të njohurive në UNIEL janë:</li> <li>• Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrje aktive në seminare e në diskutimet e leksioneve</li> <li>• Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit/projekteve individuale ose në grup)</li> <li>• Kolegiumet</li> <li>• Provimi perfundimtar</li> <li>•</li> </ul> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Referuar rregullores së programit, syllabuseve dhe informacionit të siguruar nga stafi akademik dhe studentët, rezulton se në syllabus janë parashikuar format e vlerësimit dhe masa e vlerësimit të çdo komponenti. Këto forma janë alternative dhe të ndryshme duke iu dhënë mundësi studentëve, të demonstrojnë njohuritë e përfituara. Vlerësimi dhe testimi i njohurive realizohet në forma të ndryshme të tilla si: vlerësimi me punime të pavarura, ose detyra kursi, një kontroll ose vlerësim të pjesshëm si edhe vlerësimi përfundimtar. Tezat e provimit dhe të kontrollit janë gjithëpërfshirëse, hartohen nga lektorët e lëndëve dhe miratohen nga shefi i departamentit. Testimi i dijeve përfshin teza të cilat kanë nivele të ndryshme vështirësie Brenda tyre, në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirëse për testimin e njohurive.</p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA I.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA I.8 Rregullore e programit të studimit</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion evidentoi që UNIEL ka hartuar dhe vë në zbatim rregullore dhe procedura për testimin dhe vlerësimin e njohurive të studentëve. Testimet bazuar në rregullore janë gjithëpërfshirëse dhe përfshijnë të gjitha nivelet e vështirësive. Institucioni është instance garantuese e zbatimit të këtyre rregulloreve nga stafet akademike.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>


<p><b>Standardi III.3</b></p>	
<p><b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe</p>	<p>GVJ konstatoi që testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë semestrit të vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Vlerësim</p>

<p>reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>është i bazuar në Rregulloren e Përgjithshme dhe atë të programit të studimit. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë:</p> <p>Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit të tilla si: pjesëmarrje dhe aktivizim, testim i ndërmjetëm dhe detyra kursi. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit përfaqëson 50% të vlerësimit total sipas përcaktimeve në aktet rregullatore të UNIEL dhe të pasqyruara në syllabuset e moduleve/lendëve të programit të studimit.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar i cili bazohet në provimin përfundimtar</p> <p>Studentët njoftohen për vlerësimin për secilën nga rubrikat sapa ato plotësohen dhe janë në dijeni të pikëve të marra nga vlerësimi i vazhdueshëm përpara se të zhvillojnë testin përfundimtar.</p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020- 2021</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UNIEL prej disa vitesh në bazë të projectit CLEANSCORE të financuar nga AADF, zhvillon një sistem të automatizuar të korigjimit të porvimeve. Ky lloj vlerësimi shmang format e abuzimit dhe rrit transparencën. Për mësimdhënien në prani fizike korrektesa dhe transparenca sigurohet nëpërmjet procesit të sekretimit, dhënies së notave në mënyrë individuale për çdo student duke eliminuar në këtë mënyrë mundësitë e abuzimit. Ky proces zhvillohet jo vetëm në mënyrë fizike por dhe nëpërmjet përdorimit të platformës Microsoft Office 365. Notat vendosen dhe i bëhen me dije studentëve nëpërmjet sistemit elektronik të UNIEL.</p> <p><i>EVIDENCA 3.4 Marrëveshja për implementimin e CLEANSCORE</i></p>



	<p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar për cdo lëndë bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore, dhe mund të jetë me gojë, me shkrim ose i kombinuar. Forma e vlerësimit përfundimtar i bëhet me dije studentëve në fillim të vitit akademik ndëpëmjet syllabusit të lëndës. GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion evidentoi që në rregulloret dhe bazat ligjore në UNIEL ishin të përcaktuara format e vlerësimit të cilat i bëheshin me dije studentëve në fillim të vitit akademik.</p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020- 2021</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimi me studentët u informuam që ata që në fillim të vitit akademik orientohen për secilën lëndë nga pedagogët e lëndëve në lidhje me programin e secilës lëndë dhe detyrimeve të saj. Gjithashtu nga studentët u informuam që ata njoftohen në lidhje me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të detyrat apo projektet e kursit, të cilat në fund të semestrit të vitit akademik prezantohen nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të lëndës. Studentët bazuar tek metoda e vlerësimit të vazhdueshëm, kanë mundësi të marrin komentet dhe vlerësimet e pedagogut gjatë gjithë kohës gjë që i ndihmon në procesin e të nxënimit dhe përmirësimin deri në provimin përfundimtar. Edhe në provimin përfundimtar në korigjimin e tezave të provimit, pedagogu komenton dhe evidenton të gjitha boshllëqet apo pyetjet e realizuara duke dhënë komentet përkatëse që mbështesin vlerësimin total. Gjithashtu</p>

	<p>pedagogët i vënë në dispozicion studentëve tezën e zgjidhur në mënyrë që të mundësojnë përmirësimin e tyre në të ardhmen.</p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në rregulloret e institucionit stafi akademik dhe anëtarët e komisioneve të provimit janë përgjegjës për evidentimin e plagjiaturës. Stafet akademike përgjegjëse bazuar në rregullore nuk tokerojnë plagjiaturën në cdo formë të saj sikurse dhe kopjimin në provime dhe detyra që studentët realizojnë. Studentët prgjatë provimit do të duhet të jenë të pajisur me mjet identifikimi, të mos përdorin celularët dhe cdo formë e shkeljes së rregullores së provimit i bën ata të përjashtohen nga ky i fundit. Persa i përket temave të diplomave udhëheqësi mban kontakte të vazhdueshme me studentin për ta orientuar atë si dhe i kërkon informacion të detajuar lidhur me literaturën e përdorur në secilën nga pjesët e punimit duke percaktuar mënyrën e referimit të saj. GVJ bazuar në vizitën në institucion dhe komunikimin me stafin pedagogjik u njoh me procedurat e evitimit të plagjiaturës përgjatë zhvillimit të provimeve dhe detyrave, sikurse iu komunikuan masat që ndërmerren në rastet e evidentimit të tyre.</p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.14 Rregullore e diplomimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Procesi i vlerësimit të studentëve dhe rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen në meritë dhe jepen sipas rregulloreve në fuqi. Staf i akademik përgatit provimet bazuar në të treja nivelet e vështirësisë për të mundësuar rezultatet sipas meritës. Rezultatet dalin dhe hidhen në system maksimalisht pas pesë ditësh nga dhënia e provimit. Këto procesverbale printohen nga titullari i lëndës/modulit, firmosen nga komisioni i provimit dhe pasi miratohen nga dekani dorëzohen në sekretari. GVJ evidentoi që studenti ka të drejtë të shohë provimin e korrigjuar apo të bëjë ankimim në rast se ka pretendime për rezultat të ndryshëm nga ai i vendosur.</p> <p><i>EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.22 Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike)</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.12 Rregullore EMS</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pas hedhjes së notave në sistem dhe komunikimit të tyre me gojë apo me shkrim tek studentët, këta të fundit kanë dy ditë kohë për të ballafaquar apo kundërshtuar rezultatin. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Bazuar në rregullore GVJ evidentoi që pas përfundimit të këtij afati komisioni i provimit përgatit procesverbalet finale të cilat nuk mund të ndryshojnë më. Ky konstatim na bën të theksojmë të drejtën e studentëve për të riparë dhe rivlerësuar</p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.22 Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike)</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga</p>	<p>Bazuar në RVB ankesat e studentëve që lidhen me shkeljet proceduriale të provimit, shqyrtohen nga përgjegjësi i</p>


<p>komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Departamentit dhe për dijeni vihet dhe Dekani. Këto ankesa bëhen brenda 24 orëve pas ditës së zhvillimit të provimit. Studenti ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimeve ose nuk është dakort me vlerësimin e bërë. Komisioni i përhershëm për mbrojtjen e studenteve vlerëson nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin e prerë nëse kërkesa është e drejtë apo jo. Nëse kërkesa e studentit shpallet e padrejtë, çështja pushon pa veprime apo vendime të mëtejshme. Kur ankesa vlerësohet e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studentit është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit, që studentit të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. GVJ evidentoi që e gjithë procedura administrohet nga komisioni i përhershëm për mbrojtjen e studentëve.</p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ evidentoi që intitucioni bazuar në rregulloret e tij siguron një vlerësim të drejtë për studentët dhe e bën këtë vlerësim në mënyrë transparente. Edhe në rastet e mosdakordësisë midis palëve GVJ evidentoi procedurat që i japin mundësi studentëve për ballafaqim me rezultatet në momentin që ato i gjykojnë jo të sakta.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

#### Standardi III.4


**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.**





Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznes është hartuar bazuar në ligjet në fuqi. Ai garanton thellimin e njohurive që studentët kanë përfituar përgjatë ciklit të parë të studimeve duke pëmbushur në këtë mënyrë objektivat e ciklit të dytë të studimeve korniza 7 e kualifikimeve. Gjatë shqyrtimit të programit të studimit dhe sylabuseve vërehen që një pjesë e lëndëve janë avancim i lëndëve të BA, ndërkohë një pjesë tjetër shërbejnë për të aftësuar studentët në fusha më të thelluara menaxheriale. Thellimi dhe zhvillimi i aftëive profesionale vijnë si në kuadrin teorik ashtu dhe në atë praktik bazuar në syllabuset e lëndëve që zhvillohen në këtë program studimi.</p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij - Plan i mësimor Master Profesional në Administrim</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Plan i mësimor programit Master Profesional në Administrim Biznes, përmban lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse. Për të rritur aftësitë teknologjike janë përfshirë në planin mësimor detyra kurse të cilat kërkojnë aftësitë kompjuterike për tu realizuar. Edhe për rritjen e aftësive gjuhësore institucioni ka përfshirë në planin mësimor raste studimore të cilat janë në gjuhën angleze apo dhe literaturë shtesë në gjuhën angleze. Për rritjen e aftësive komunikuese dhe ndërvepruese në program janë përfshirë detyrat e grupit të cilat studentët i realizojnë në lëndë të ndryshme</p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij - Plan i mësimor Master Profesional në Administrim</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit sikurse dhe bazuar në RVB, rezultoi se në fillim të cdo semestri, studentët marrin informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Në syllabuset e lëndëve studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në lëndën përkatëse. Këtu ato njihen me kohëzgjatjen e kursit, temat, detyrimin e frekuentimit, mënyrën e vlerësimit, si dhe literaturën bazë dhe plotësuese sikurse dhe me numrin e krediteve të cdo</p>

<p>rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>lënde. Në seancën e fundit të semestrit çdo pedagog në fund të semestrit mbas përfundimit të lëndës, realizon një përmbledhje të temave kryesore dhe analizon çështjet e ndryshme që janë konstatuar gjatë trajtimit si të panevojshme apo të pa plotësuar. Gjithashtu, në grupet mësimore diskutohen çështje për përmirësimin në vazhdimësi të syllabusit si dhe çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin në vazhdimësi të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe në mënyrë të strukturuar i paraqiten departamentit për diskutim.</p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij - Plani mësimor Master Profesional në Administrim</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.17 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjise së informacionit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Master Profesional në Administrim Biznes është ndërtuar në mënyrë që tu japë studentëve kompetenca dhe aftësi të cilat i përgjigjen kërkesave të tregut. Ky program studimi është i përshtatshëm dhe është ndërtuar në mënyrë të tillë që thellon njohuritë e përfituara në programin e ciklit të parë të studimeve. Syllabuset e lëndëve të këtij programi u japin mundësinë studentëve të realizojnë e vlerësohen nëpërmjet detyrave të kursit. Detyrat apo projektet e kursit qofshin ato individuale apo punë në grup simulojnë raste nga biznese reale, ku studentët mund të zbatojnë në praktikë dijet teorike, të zhvillojnë analiza dhe zgjidhje të problemeve reale të bizneseve apo dhe të mësojnë e realizojnë punën në grup. Gjithashtu përgjatë zhvillimit të këtij program studimi, stafi akademik inkurajon studentët që të marrin pjesë në punë kërkimore-shkencore. Një evidentim i kësaj mbështetjeje është dhe pjesëmarrja e studentëve në konferenca si dhe në projekte ndërkombëtare. Për rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët si dhe për tu dhënë atyre aftësi praktike, për studentët ofrohen dhe mobilitete. Mobilitetet i ndihmojnë studentët për marrë një formim profesional alternativ si dhe krijon mundësi punësimi. Gjithashtu këto mobilitete rrisin mundësitë për kërkime studentore dhe akademike internacionale dhe interdisiplinare.</p>





	<p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020- 2021</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.22 Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike)</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.19 Konferenca e 9-të shkencore_FE 2021</i></p> <p><i>EVIDENCA 3. 16 Buletine shkencor _UNIEL dhe FE</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkepunimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik mban në fokus në realizimin e mësimdhënies dhe zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë. GVJ bazuar në vizitën në institucion evidentoi që bashkëpunimi ndërdepartamental mundëson realizimin e orëve të hapura që lidhen me avancimet dhe përdorimin e teknologjisë. Gjithashtu në këtë program studimi në UNIEL janë zhvilluar dhe orë të hapura në formë leksionesh apo seminaresh të cilat nuk janë pjesë e strukturës mësimore. Të gjitha këto kanë patur në fokus përdorimin e teknologjisë në fushat e administrim biznesit apo zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë.</p> <p><i>EVIDENCA 3.17 Publikimi i të dhënave, takimeve, aktiviteteve dhe njoftimeve ne ëbsite UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.17 Udheëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.4 Publikimi i spotit promovues</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.1 Guida e pedagogut Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara</p>	<p>Shpenzimet financiare të studentëve për pjesëmarrje në konferenca studentore mbuloheh financiarisht nga institucioni. Institucioni mbështet interesimin, pjesëmarrjen dhe zhvillimin e aktiviteteve që</p>


<p>kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>promovojnë idetë novatore ku studentët e institucionit gjejnë mjedis për zhvillimin e ideve të tyre. Studentët inkurajohen që në fund të ciklit të studimit të realizojnë temë diplome. Temat të cilat vlerësohen maksimalisht inkurajohen të marrin pjesë në konferenca.</p> <p><i>EVIDENCA 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.17 Publikimi i të dhënave, takimeve, aktiviteteve dhe njoftimeve ne ëbsite UNIEL</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në vizitën në institucion dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, gjykon që programi i studimit MPAB synon dhe garanton rritjen e aftësive krijuese dhe zbatuese tek studentët. Ky program synon rritjen e kompetencave teorike dhe praktike me ndihmën e personelit akademik dhe vetë institucionit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.5</b></p>	
<p><b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Referuar rregullores së institucionit, të njësisë kryesore, rregullores së programit të studimit si dhe procedurës së diplomimit, cikli i dytë i studimeve Master Profesional përmbillet me punim diplome ose provim final. Departamenti i Administrim Biznesi pranë Fakultetit të Ekonomisë si njësi bazë, përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional ne “Administrim Biznes”, harton paraprakisht një paketë udhëzuese lidhur me procedurat dhe afatet kohore, udhëzimet mbi strukturën si dhe</p>



	<p>rregullat e ndryshme për procesin e mbrojtjes së diplomës dhe i njeh studentët me këto procedura dhe udhëzime, për t'ju ardhur në ndihmë atyre, që të përfundojnë me sukses të gjitha hapat deri në mbrojtje të diplomës për këtë program studimi.</p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.11 Dosja e përgatitjes së temës së diplomës</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ bazuar në vizitën në institucion iu komunikua se i gjithë personeli akademik pjesë e programit të studimit MP në AB vë në dispozicion të studentëve materialet ndihmëse, udhëzuesin dhe informacionin për përmbylljen e detyrimeve përmbyllëse. GVJ ju bë me dije që kishte një procedurë të posacme e cila kishte këto hapa:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në fillim të muajit prill të cdo viti akademik përcaktoheshin studentët që do të diplomoheshin nëpërmjet mbrojtjes me punim diplome, ku sipas rregullores përfshiheshin studentët që kanë arritur rezultate të larta.</li> <li>• Më pas vazhdohej me depozitimin individual nga studentët të kërkesës për të realizuar një punim diplome. Studentët depozitojnë individualisht propozimin dhe për pedagogun udhëheqës.</li> <li>• Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat e studentëve, dhe përzgjedh në bazë të kriterëve studentët që do të përgatisin një punim diplome.</li> <li>• Më pas përcaktohet udhëheqësi dhe lista i kalon Dekanit.</li> </ul> <p>Studentët të cilët nuk plotesojnë kriteret për mbrojtjen me punim diplome apo nuk kanë dëshirë të zhvillojnë punim diplome zhvillojnë provim të përgjithshëm formimi. Ky provim është gjithëpërfshirës dhe hartohet nga komisioni i provimit dhe mbrohet me gojë përpara komisionit. E gjithë kjo procedurë GVJ iu bë me dije nga dokumentacioni por dhe nga takimi me stafin akademik dhe studentë.</p>

	<p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndeve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.11 Dosja e përgatitjes së temes së diplomës</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e fakultetit provimi përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bëhen përpara komisionit të përbërë nga stafi akademik që mbulon programin e studimit. Komisioni ndjek rregulloret dhe procedurat për cdo student. Bazuar në dokumentacion dhe në evidence të reflektuara përgjatë takimit, komisioni përcaktohet nga shefi i departamentit dhe miratohet nga Dekani. Për provimin përfundimtar, referuar rregulloreve të institucionit për studentët të cilët kryejnë provim final, stafi akademik është përgjegjës për përgatitjen e një databazë pyetjesh të cilat pasi miratohen në department dhe i paraqiten studentëve. Në bazë të rregullores testet duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të testojnë njohuritë e marra përgjatë zhvillimit të programit. Databaza e pyetjeve ndërtohet nga databazat e lëndëve përkatëse dhe secili pedagog është pjesë për realizimin e saj.</p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndeve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.11 Dosja e përgatitjes së temes së diplomës</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e</p>	<p>Bazuar në rregulloret e institucionit personeli akademik i cili është përzgjedhur si udhëheqës për temën e diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i ofron studentit të gjithë asistencën e nevojshme për realizimin e punimit të diplomës. Kjo asistencë konsiston nga fillimi i kërkimit deri në shkrimin e punimit, duke garantuar në këtë mënyrë cilësinë dhe origjinalitetin e tij. Udhëheqësi në përfundim të punimit kryen një vlerësim të shkurtër me anë të të cilit e miraton ose në rastet kur studenti nuk i është përmbajtur kritereve dhe udhëzimeve të tij jep bën vërejtjet e nevojshme në funksion të përmirësimit të punimit. Ky raport i</p>


<p>rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>paraqitet komisionit së bashku me punimin e temës së diplomës. Dokumentacioni gjendet në dosjen e programit.</p> <p>GVJ bazuar në vizitat në institucion dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, konstatoi që në programin e studimit Master Profesional në Administrim Biznes, kryesisht finalizimi i studimeve mbyllet me zhvillimin e provimit të përgjithshëm përfundimtar.</p> <p><i>EVIDENCA 3.10 Manuali i punimit të diplomës</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.11 Dosja e përgatitjes së temës së diplomës</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. Asistencën në këto aktivitete GVJ e dëgjoi që, UNIEL e jep dhe për organizimet e ekspeditave studentore dhe në zhvillimin e metodologjive kërkimore në realizimin e temave të diplomës. Institucioni vë në dispozicion të studentëve jo vetëm stafin akademik por gjithashtu dhe laboratorët dhe bibliotekën fizike dhe online.</p> <p><i>EVIDENCA 2.4 Realizimi i ekspeditave studentore për vitin akademik 2021-2022</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturen e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturen e Bibliotekës UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.9 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturen e laboratorëve TIK</i></p>

	<i>EVIDENCA 4.17 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit</i>
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	<p>Bazuar në rregulloret e institucionit, në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë për të cilën bëhet me dije në ditën e mbrojtjes së diplomës. Studentët që vlerësohen me notë kaluese në mbrojtjen e diplomes mbyllin ciklin e parë të studimeve MP në Administrim Biznesi.</p> <p>Bazuar në po të njëjtat rregullore studentët të cilët mbyllin këtë cikël studimi me provim përfundimtar vlerësohen gjithashtu me notë nga komisioni i provimit i cili përbëhet nga 3-5 pedagogë. Nota e vendosur është mesatare e të gjithë anëtarëve të komisionit. Përfundimi i këtij provimi apo i kësaj mbrojtjeje diplome, dhe vlerësimi pozitiv në to, i jep mundësi studentëve të marrin diplomën e këtij programi studimi.</p> <p><i>EVIDENCA 1.22 Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike)</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.11 Dosja e përgatitjes së temës së diplomës</i></p>
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<p>Bazuar në rregullore, në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. GVJ evidentoi se bazuar në kërkesën e tyre studentët në përfundim të studimeve, i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Procedurat sipas rregullores aplikohen vetëm në momentin që studentët kanë notë pozitive në provimin përfundimtar ose në mbrojtjen e temës së diplomës.</p> <p><i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL</i></p>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas	<p>Nga informacioni i marrë në Sekretarinë Mësimore, GVJ u informua që institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit sipas legjislacionit në fuqi. Dokumentacioni për studentët ruhen nga Fakulteti Ekonomik për një periudhe të</p>

<p>rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>pacaktuar në hard copy dhe ky dokumentacion i vihet në dispozicion studentit sa herë që ky i fundit paraqet kërkesë.</p> <p><i>EVIDENCA 3.6 Rregullore për krijimin regjistrimin ruajtjen shërbimin dorëzimin e dokumentave në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UNIEL ka hartuar procedura të qarta për detyrimet përmbyllëse të programit të studimit MPAB. GVJ evidentoi bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe vizitës në institucion, se studentëve i vihet në dispozicion ky dokumentacion i detyrimeve përmbyllëse dhe ndiqen në cdo hap të këtij procesi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.6</b></p> <p><b>Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Institucioni ndjek zhvillimin e praktikave mësimore me stafin e programit të studimit. Mënyra e organizimit dhe zhvillimit të praktikave profesionale janë të sanksionuara në rregulloret e institucionit. Bazuar në dokumentacion GVJ evidentoi dy mënyra të përzgjedhjes së kompanive për zhvillimin e praktikave mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësia bazë evidenton kompanitë apo institucionet e mundshme ku studenti mund të kryejë praktikën profesionale.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mënyra e dytë e përzgjedhjes së vendit të praktikës vjen nga studentët. Studentët mund të propozojnë vetë vendin e kryerjes së praktikës.</li> </ul> <p>Ndarja e studentëve në kompani bëhet bazuar në dëshirën e studentit sikurse dhe në profilin e studimit. Studenti paraqitet në institucion vetëm me lejen e dhënë nga përgjegjësi i departamentit dhe të firmosur nga Dekani. Kjo procedurë që ndiqet për zhvillimin e praktikës mësimore GVJ iu bë me dije dhe në takimin me studentët.</p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion personelin e brendshëm për instruktim, udhëheqje dhe monitorimin e studentëve në praktikën profesionale. Raporti pedagog student për këtë program studimi është i favorshëm. Praktikrat profesionale në bazë të dokumentacionit në dispozicion zhvillohen pranë kompanive që UNIEL ka marrëveshje bashkëpunimi. Në dokumentacionin e paraqitur nga insticioni përshkruhen me hollësi procedurat e zhvillimit të praktikës si dhe udhëzimet për punimin e diplomës.</p> <p><i>EVIDENCA 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e fakultetit</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë</p>	<p>GVJ evidentoi që pas përfundimit të praktikës studentët marrin nga vendi i prektikës një vërtetim i cili përmban dhe vlerësimin e tyre në vendin e praktikës profesionale. Vlerësimi kryhet nga</p>



studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	mbikëqyrësi në praktikën profesionale. Këtë vlerësim i cili mund të jetë me notë ose me komente studentët ia paraqesin komisionit të vlerësimit të praktikave së bashku me punimin që ata kanë bërë. Në përfundim të mbrojtjes së praktikës profesionale studentët vlerësohen me notë e cila ka ekuivalentimin e saj dhe në kredite.  <i>EVIDENCA 1.21 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite (MP në AB)</i>  <i>EVIDENCA 2.10 Dosja e plotë e praktikës mësimore</i>  <i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ bazuar në dokumentacion konstatoi ekzistencën e procedurave për zhvillimin e praktikës mësimore në programin e studimit MPAB. Përzgjedhja e vendit të praktikës bëhej ose nëpërmjet marrëveshjeve ose nëpërmjet përzgjedhjes së studentit dhe ndiqej nga stafi akademik.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  X
---	--	------------------------------	-----------------------------	---------------------------------------

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>  <b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë,	Referuar dosjes së vetëvlerësimit, konstatohet se stafi akademik i programit të studimit Master Profesional në Administrim Biznesi,




personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

përmbush kërkesat ligjore, për nivelin e kualifikimit akademik dhe për fushën e ekspertizës. Në këtë program studimi janë të përfshirë 8 pedagogë gjithsej, ndër të cilët 7 janë staf efektiv (PAE) dhe 1 staf me kontrate (PAK).

Tituj/grada	2021 - 2022	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1
Prof.As.Dr	3	-
Dr/PhD	3	-
Msc	-	-
Në total	7	1

Drejtues i programit është një prej pedagogëve të programit të studimit, me fushë ekspertize “Manaxhim” dhe me titullin “Profesor i Asociuar”. Stafi administrativ është në nivel fakulteti, për shkak të numrit të vogël të studentëve.

*(EVIDENCA 1.24 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit Master Profesional në Administrim Biznes.pdf)*

*(Evidenca 1.26 CV MP Administrim Biznes.pdf)*

*EVIDENCA 2.15 Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit; Detyrat e koordinatorit të programit.pdf*

**Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.


Duke iu referuar planit mesimor si dhe shpërndarjes së ngarkesës, rezulton se personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën orare si dhe numrin e lëndëve, në zbatim Udhezimit 29 dt 10.09.2018 te MAS. Referuar *Dokumenti RVB, Tabela, 12.2 Ngarkesa totale e stafit akademik të programit të studimit MPAB*, rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë.

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2020-2021	675	600	75	89% / 11 %




	<i>EVIDENCA 2.20 Raport Vlerësimi për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Administrim Biznes.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	<p>Gvj duke u mbështetur në dokumentacionin e DVV si dhe at`t`siguruar gjatë vizitës në institucion, konstaton se për tre vite, nuk ka qarkullim stafi. Stafi paraqet qëndrueshmëri, përfshi edhe stafin e jashtëm. Referuar listëpagesave n DVV si dhe vizites ne institucionë, në dosjet e stafit, rezultojnë kontratat e punësimit për stafin akademik si dhe atë joakademik.</p> <p><i>(EVIDENCA 4.1 Listëpagesa e personelit janar-qershor 2022 FE.xlsx)</i></p> <p><i>(EVIDENCA 1.24 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit Master Profesional në Administrim Biznes.pdf)</i></p> <p><i>(Evidenca 1.26 CV MP Administrim Biznes.pdf)</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konsultoi praktika të rekrutimi të cilat, mbështeten në procedura rekrutimi dhe vlerësimi, me kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. Kriteret propozohen nga Departamenti e miratohen nga Dekani e Rektori. Në vijim ato publikohen në webin e institucionit. Vlerësimi bëhet mbi procedura të ndara në dy faza, vlerësimi i dosjes dhe intervista. Komisioni miratohet nga rektori, komisioni propozon renditjen përfundimtare të kandidatëve dhe miratimi bëhet nga rektori. Theksojme se stafi i programit për disa vite rrjesht është i qëndrueshëm dhe pa ndryshime, por GVJ konsultoi një praktikë rekrutimi të departamentit, edhe pse nuk i përkiste këtij program studimi.</p> <p><i>(EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit.pdf)</i></p> <p><i>(EVIDENCA 1.30 Formati i Dosjes personale të stafit.pdf)</i></p> <p><i>(EVIDENCA 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UNIEL.pdf)</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e	Referuar planit mësimor, ky program nuk ka një natyrë specifike teknike, të mbështetur në orë laborator, por pavarësisht natyrës së programit të studimit MP në AB, nga vizita në institucion dhe nga konsultimi i organogramës së institucionit, rezulton se institucioni garanton staf ndihmës akademik për realizimin e orëve

<p>orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>laboratorike të programeve të studimit apo të mbështetjes së studentëve gjatë procesit të shkrimit të temave të diplomës.</p> <p><i>(EVIDENCA 1.11 Struktura organizative e UNIEL.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Referuar dosjes së programit të studimit MP në AB si dhe DVV, GVJ pati në dispozicion informacion për stafin akademik efektiv dhe joefektiv të tre viteve të fundit, ngarkesa e tyre sipas semestrave, lëndët që mbulojnë, Cv-të e tyre si dhe në zyrën e burimeve njerëzore u konsultuan informacion edhe i dosjeve të tyre, kualifikimet akademike, kontratat, Cv-te, Librezat e punës etj.</p> <p>Për sa më sipër GVJ është e mendimit që informacioni i kërkuar në këtë kriter është i plotë.</p> <p><i>(EVIDENCA 1.30 Formati i Dosjes personale të stafit.pdf)</i></p> <p><i>(EVIDENCA 1.24 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit Master Profesional në Administrim Biznes.pdf)</i></p> <p><i>(Evidenca 1.26 CV MP Administrim Biznes.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni vendosi në dispozicion një listë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompani në rajon për mundësimin e praktikave mësimore të studentëve dhe mbikëqyrjen e tyre. Ky process lehtësohet edhe nga fakti që numri i studentëve në këtë program studimi, paraqitet i vogël. Vlen për të theksuar që institucioni ka krijuar Bordin Këshillimor të Biznesit, si bord suportiv për praktikën mësimore, për punësimin e studentëve apo për këshillimin për përmirësimin e programeve mësimore.</p> <p><i>(EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij.pdf)</i></p> <p><i>(EVIDENCA 2.10 Dosja e plotë e praktikës mësimore.pdf)</i></p> <p><i>(EVIDENCA 4.6 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillor të Biznesit 2021-2022.pdf)</i></p> <p><i>(EVIDENCA 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që</p>	<p>Marrëveshjet mes UNIEL dhe institucioneve/kompanive kanë të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve. Referuar dosjes së</p>

<p>angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>praktikës konstatohet se mbikqyrësi i praktikës në biznes është pjesë e vlerësimit të studentit. Ai është përgjegjës për vlerësimin e studentit gjatë praktikës profesionale. Vlerësimi i tij është pjesë e dosjes individuale të praktikës së studentit.</p> <p><i>(EVIDENCA 2.10 Dosja e plotë e praktikës mësimore.pdf)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ mbështetur në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe në vizitën në institucion, vlerëson se personeli akademik që mbulon programin e studimit MP AB në UNIEL, përmbush standardet sasiore dhe cilesore. Institucioni deshmon se ka numrin e duhur dhe me kualifikimin e duhur e të posaçëm, te stafit akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Institucioni, ndjek praktika rekrutimi dhe vlerësimi mbështetur në rregulloren e institucionit dhe i ben ato transparente.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të</p>	<p>GVJ duke konsultuar dokumentacionin për infrastrukturën si dhe nga vizita në mjediset e UNIEL, konstaton se mjediset janë mjedise të përshtatshme për zhvillimin e leksioneve/seminareve.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë, disponon 15 salla leksionesh dhe 7 salla për seminare si dhe 4 laboratorë. Kapaciteti i tyre është 2706 M2, ndër të cilat 1865 m2 janë në dispozicion të mësimdhënies, klasave dhe laboratorëve. Për stafin e fakultetit rezultojnë në dispozicion 16 zyra.</p>

studimit dhe moduleve përkatëse.	<i>(EVIDENCA 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit.pdf)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Referuar vizitës në institucion, konstatohen se klasat dhe laboratorët, janë me kapacitete të mjaftueshme, përgjithësisht rezultonin të pajisur me videoprojektorë, white bord, PC dhe si dhe rrjet kabllor internet, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Gjatë vizitës në institucion, në mjediset e fakultetit rezulton se sallat e leksioneve dhe seminareve si dhe laboratorët, kanë pajisjet e teknologjisë së informacionit, kompjutera dhe softet që i shërbejnë plotësimin të objektivave të programit, për realizimin e detyrave, prezantimeve audio vizive apo për përpunimet kompjuterike, në përputhje me natyrën e lëndëve të programit të studimit MP në AB,  <i>(EVIDENCA 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve të FE.xlsx; EVIDENCA 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve KORPUSI FSHH.xlsx)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Referuar evidencës infrastrukturore, rezultojnë 4 laboratorë disponibel. Gjatë vizitës në institucion konstatohen se laboratorët kanë pajisjet e teknologjisë së informacionit, kompjutera dhe softet që përputhen me natyrën e lëndëve specifike të programit të studimit MP në AB, që i shërbejnë jo vetëm lëndës së informatikës, por edhe lëndëve të tjera si kontabilitetit aplikativ etj.  <i>EVIDENCA 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve të FE.xlsx; EVIDENCA 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve KORPUSI FSHH.xlsx</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar	Referuar vizitës në institucion si dhe RVB rezulton se UNIEL dhe njësia kryesore, disponon një tërësi marrëveshjes me institucione të ndryshme, të cilat mbështesin dhe mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale, kryesisht në mjediset e tyre.

<p>nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>									
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se UNIEL vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit MP në AB, si dhe për formimin praktik të studentëve të këtij programi. Keto mjedise garantojnë, kapacitetet e duhura fizike, laboratorike dhe me pajisjet e duhura për procese mesimdhënëse cilesore.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="564 1039 746 1133">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="751 1039 978 1133">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="983 1039 1187 1133">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1192 1039 1401 1133">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="564 1140 746 1189"></td> <td data-bbox="751 1140 978 1189"></td> <td data-bbox="983 1140 1187 1189"></td> <td data-bbox="1192 1140 1401 1189" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi IV.3</b></p> <p><b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>




<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konsultoi syllabuset e lëndëve, vizitoi bibliotekën e institucionit si dhe komunikoi me stafin dhe studentët gjatë vizitës në institucion nga ku rezulton se në dispozicion të studentëve është vendosur literature bazë dhe ndihmëse në shërbim të njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Kjo literaturë është në gjuhën shqipe dhe angleze. Burimet e saj gjenden fizikisht si dhe në bibliotekat elektronike qe institucioni ka mundësuar</p> <p><i>(EVIDENCA 2.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library.pdf</i> <i>EVIDENCA 2.8 Fondi i librit.pdfj;</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Referuar dosjes së vetëvlerësimit rezulton se literatura në programet e lëndëve është kryesisht në gjuhën shqipe, libra universitarë në përputhje me programin. Biblioteka pasurohet në vijueshmëri. Mbështetje për pasurimin e bibliotekës dhe mundësive për literaturë është edhe regjistrimi në Jstore dhe mundësia për të shfrytëzuar fondin e publikimeve në Jstore nga stafi dhe studentët.</p> <p><i>(EVIDENCA 3.12 Lista e teksteve periodikëve në Bibliotekë (hard copy dhe e-book), të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit.pdf;</i></p> <p><i>EVIDENCA 2.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library.pdf</i> <i>EVIDENCA 2.8 Fondi i librit.pdfj; EVIDENCA 2.9 Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UNIEL vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore. Kjo bibliotekë është në shërbim për studentët e disa njësive kryesore. Referuar evidencave për infrastrukturën e UNIEL, sipërfaqja e saj është 972 m<sup>2</sup> me poste dhe Pc.</p> <p>Ndërkohë që në Fakultetin Ekonomik është një bibliotekë me sipërfaqe 88m<sup>2</sup> dhe kapacitet 1000 libra, në dispozicion të programeve të studimit të njësisë kryesore, Fakulteti Ekonomik</p> <p><i>(EVIDENCA 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë,</p>	<p>Duke iu referuar fondit të librit si dhe kapacitetit të bibliotekës rezulton se, ajo është e pajisur me fond fizik librash në mbështetje</p>

<p>literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>të programit të studimit MP në AB, si literaturë bazë dhe ndihmëse si dhe revista shkencore në periodikë të fushave të ndryshme.</p> <p>Në këtë fond të literaturës, janë librat bazë për lëndët e PS MP në AB, si dhe literatura ndihmëse, shqip ose anglisht, sipas programit të lëndëve. Pavarësisht kësaj është e nevojshme azhurnimi i bibliotekës me literature fizike të përditësuar.</p> <p>Në shërbim të studentëve është edhe fondi elektronik i literaturës në gjuhë të huaj, on-line të Jstore libra, periodikë, revista shkencore, proceedings të konferencave, ku studentët kanë mundësi të hulumtojnë materiale për lëndët si dhe për zhvillimin e temës së diplomës.</p> <p><i>(EVIDENCA 2.8 Fondi i librit.pdf; EVIDENCA 3.12 Lista e teksteve periodikëve në Bibliotekë (hard copy dhe e-book)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ofron kushte për shfrytëzim dhe akses të barabartë të fondit fizik dhe atij elektronik dhe pa pagesë për studentët e kësaj njësie kryesore. Nga vizita në institucion rezulton se mjediset e bibliotekës janë në dispozicion të studentëve jo vetëm për shfrytëzimin e fondit të librit, por edhe si sallë studimi gjatë semestrit apo sezoneve të provimeve.</p> <p><i>(EVIDENCA 4.8 Të dhena mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Bibliotekës UNIEL.xlsx</i></p> <p><i>2.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library.pdf EVIDENCA 2.8 Fondi i librit.pdf; EVIDENCA 4.10 Dokumenti për njoftimin e projektit për digjitalizimin e Bibliotekës UNIEL.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Referuar evidencës infrastrukturore të bibliotekës si dhe vizitës në institucion salla e bibliotekës është e pajisur me PC dhe disa pajisje të tjera si skaner e fotokopje. Studentët mund të aksesojnë edhe librarianë elektronike JStore. Nga vizita në institucion u konstatua se Institucioni është fitues edhe i një projekti të AKKSHI, për digjitalizimin e bibliotekave që do të lehtësojë e modernizojë shërbimin e bibliotekës për të gjithë përdoruesit.</p> <p><i>(EVIDENCA 4.8 Të dhena mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Bibliotekës UNIEL.xlsx</i></p> <p><i>2.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të</p>	<p>Referuar RVB si dhe vizitës në institucion, biblioteka funksionon në orare zyrtare 08-16.00, nga e hëna në të premte, në shërbim të</p>

<p>studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>studentëve, por përvec orareve të shfrytëzimit fizik të bibliotekës është edhe mundësia e aksesimit on-line të Jstore, edhe nga ambiente jashtë instiucionit duke rritur mundesine shfrytëzimit të fondit të librit nga stafi dhe studentët.</p> <p><i>(EVIDENCA 4.11 Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL.pdf)</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>GVJ konstatoi në dosjen e vetëvlerësimit të MP nëAB se funksionimi i bibliotekës, pasurimi i saj, cilësia e fondit të librit, është pjesë e analizës vjetore të institucionit.</p> <p>Pavarësisht për sa më sipër, <i>GVJ sugjeron</i> shtimin e fondit fizik të librit në gjuhën shqipe dhe përditësimin e saj, në përputhje me programin e studimit dhe sugjeron që kërkesat për libra të bëhen periodikisht nga stafi i departamentit si dhe të kenë një fond të parashikuar në buxhet për pasurimin e përvitshëm të bibliotekës.</p> <p><i>(EVIDENCA 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021.pdf)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se kushtet infrastrukturale të bibliotekës janë të vlerësueshme, institucioni ka regjistrim në biblioteka elektronike të akseueshme nga stafi dhe studentët. GVJ sugjeron pasurimin e dhe përditësimin e fondit të bibliotekës fizike me botimet recente të titujve në përputhje me programin e studimit MPAB</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

**Standardi IV.4**






<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar RVB, vizitës në institucion si dhe evidencave të DVV, GVJ konstaton se, UNIEL disponon një sistem të menaxhimit të informacionit EMS - Education Management System, që siguron akses për këta përdorues: studentët, stafin akademik, sekretaritë si dhe zyrën e IT. Sistemi EMS administron informacionin nga rregjistrimi deri ne dalje, për studentët e programit.  <i>(EVIDENCA 4.12 Rregullorja EMS.pdf)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konstaton se përvec sistemit elektronik EMS, për stafin dhe studentët informacioni mbahet edhe në formë shkresore. Për studentët informacioni përvecse në systemin EMS, rezulton i ruajtur edhe nëpërmjet rregjistrimit themeltar, rregjistrimit të përparimit akademik të studentëve, si dhe rregjistrimit të lëshimit të diplomave. Keto rregjistra u konsultuan nga GVJ gjatë vizitës në institucion dhe që rezultuan me informacione plotë të kërkuar. Referuar përdorimit të EMS, GVJ konstatoi se sistemi EMS, ka hapësirën virtuale të cdo pedagogu/lënde, për komunikim interaktiv me studentët.  <i>(EVIDENCA 4.12 Rregullorja EMS.pdf)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ nga takimet me stafin akademik, studentët si dhe sekretarinë, dhe konsultimit të dokumentacionit, konstaton se përvec formës shkresore të ruajtjes së informacionit në rregjistra, institucioni ka sistemin elektronik EMS, që rezulton të jetë aktiv prej 2020 dhe të ofrojë në mënyrë efektive dhe koherente informacion për studentët dhe vlerësimet e tyre, procesverbalet e lëndëve të ndryshme, mundësi komunikimi interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik, lehtësi në menaxhimin e informacionit për sekretaritë etj. Referuar moduleve që EMS ka, ai paraqet hapësirë të dedikuar për studentët, stafin, sekretarinë, financën, aksesimin e bibliotekës on-line etj.
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që	Përdoruesit e sistemit rezultojnë të kenë akses të dedikuar në sistem nëpërmjet kredencialeve të tyre personale, nga vizita në institucion rezultoi se stafi akademik informon studentët për rezultatet

<p>mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>nëpërmjet sistemit, studentët informohen në kohë reale për to, kanë të drejtën të paraqesin kërkesat për rishikim nëpërmjet sistemit e të informohen po në sistem për vlerësimin e tyre final. Sistemi elektronik i informacionit të manaxhimit EMS, rezulton një sistem i integruar me platforma dhe module që suportojnë komunikimin interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik, duke e bërë atë më efektiv.</p> <p><i>(EVIDENCA 4.12 Rregullorja EMS.pdf)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>GVJ është i mendimit që, nëpërmjet mënyrës se si është konfiguruar sistemi elektronik EMS i UNIEL, deadlineve të vendosura në sistem, ndërlidhjes mes moduleve që ka, ai lejon kontroll dhe monitorim në kohë të aktiviteteve administrative, njoftimet për vlerësimin e studentëve, dhënien e notave finale, shqyrtimin e ankimeve, dorëzimin e procesverbaleve, dërgimin e materialeve lëndore, plotësimin e detyrimeve të studentit, si plotësimi i pyetësorëve, etj</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>UNIEL ka një faqe interneti me informacion të përmbledhur për të gjitha njësitë kryesore si dhe informacion që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme të njërive të tjera.</p> <p><i>(EVIDENCA 4.13 Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB.pdf)</i></p> <p><i>Universiteti "Aleksander Xhuvani" : Fakulteti : Programi (ems.al)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se UNIEL ka një sistem të integruar të informacionit që siguron informacion të plotë për pale të ndryshme të përdoruesve, si për studentët dhe stafin akademik dhe mbështet bashkërendimin e shumë proceseve akademike dhe administrative me efektivitet</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.5**

<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton se në zbatim të legjislacionit në fuqi, UNIEL, harton një raport vjetor. Pjesë e këtij raporti rezultojnë të jetë edhe raportimi financiar i cili kalon për miratim në senat dhe më pas në bordin e Administrimit. GVJ konstatoi gjithashtu se institucioni ka hartuar një raport të analizës së kostove të programeve të studimit sipas niveleve të studimit, bch, master apo programe dyvjeçare <i>(EVIDENCA 4.19 Informacione mbi kosot e studimit dhe tarifat e shkollimit ne FE.pdf)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezultojnë se kërkesat buxhetore propozohen nga njësi bazë dhe ajo kryesore, organizohen në nivel institucioni dhe miratohen nga senati si dhe nga bordi i Administrimit. Të dhënat në të jepen për shpenzimet e planifikuara për financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura etj. <i>EVIDENCA 4.16 Kërkesa për projekt buxhetin e UNIEL.pdf</i> <i>EVIDENCA 4.15 Miratimi i regjistrimit të prokurimeve dhe shërbimeve 2022.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UNIEL si institucion publik i arsimit të lartë, auditohet financiarisht në disa forma. Institucioni i nënshtrohet auditimit të brendshëm, i cili monitoron ecurinë e procesve shpenzuese/investuese dhe lejon të kryhen rregullimet e duhura për efektivitetin e këtyre proceseve. Përveç auditimit të brendshëm, UNIEL auditohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit si dhe nga KLSH. Për rekomandimet e dy institucioneve të fundit institucioni ka detyrimin e hartimit të një plani masash për përmbushjen e tyre. Sic rezultojnë edhe nga DVV, institucioni kryen edhe auditim të jashtëm, nëpërmjet një marrëveshje të lidhur me një kompani auditimi.

	<i>(EVIDENCA 4.14 Raporti i Auditit KLSH 2022.pdf)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ konstaton në sistemin AMS se UNIEL ka depozituar raportet vjetore ku raportohet edhe realizimi i buxhetit të miratuar. Ky raportim paraqitet në nivel departamentit dhe jo në nivel programi.  <i>(EVIDENCA 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021.pdf)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Referuar raportit vjetor si dhe RVB, rezultojnë se UNIEL si institucion publik, siguron të ardhurat nga granti për mësimdhënien si dhe nga të ardhurat nga tarifat e studentëve.  Gjithashtu GVJ konsultoi edhe listë pagesat e për stafin akademik dhe administrativ të FSHE për 2022, çfarë demonstron aftësinë për të paguar detyrimet ndaj stafit të institucionit  Pavarësisht sa më sipër, në kushtet e zvogëlimit të numrit të studentëve, <i>GVJ është e mendimit se UNIEL duhet të sigurojë forma alternative të gjenerimit të fondeve në të ardhmen nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare etj.</i>  <i>(EVIDENCA 4.1 Listëpagesa e personelit janar-qershor 2022 FSHE.xlsx)</i>  <i>(EVIDENCA 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021.pdf)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se UNIEL si institucion publik, funksionon në respekt të legjislacionit, harton dhe miraton buxhetet vjetore si dhe raporton realizimin e tij. Institucioni i nënshtrohet disa formave të auditimit, të brendshme, të MAS dhe KLSH për sigurimin e përdorimit të fondeve në përmbushjen e objektivave të programeve të studimit</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ konstaton se UNIEL ka një sërë rregulloresh dhe procedurash duke filluar nga niveli institucional në tërësi e deri tek departamenti apo programi i studimit që mbulojnë një cikël të plotë të masterit profesional në AB, nga hyrja deri në diplomim të studentëve në PS MPAB. Këto procedura janë të sanksionuara respektivisht në <i>nenin 12</i> të rregullores së Fakultetit Ekonomik dhe në <i>nenin 40</i> të rregullores së institucionit, si dhe në Strategjinë e zhvillimit të UNIEL 20-24, ku ndër objektivat e kësaj strategjie gjenden edhe objektivat specifike për studentët</p> <p><i>(EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit.pdf, DVV; EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.pdf; EVIDENCA 1.3 Strategjia e UNIEL.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Dokumentat, si strategjia e institucionit, rregullore e fakultetit, rregullore e programit, fokusohen në trajtimin e barabartë dhe sipas meritokracisë, referuar procedurave të përzgjedhjes së studentëve si dhe atyre të vlerësimit të avancimit akademik të tyre. Në përputhje me detyrimet ligjore, institucioni ka krijuar Komisionin për mbrojtjen e të drejtave të studentëve, që konsiderohet një komision që është avokat i të drejtave të studentëve, <i>(Neni 40 i rregullres së UNIEL)</i></p> <p><i>(EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me</p>	<p>Referuar takimeve me drejtues së njësisë kryesore dhe asaj bazë si dhe DVV, rezulton se departamenti dhe fakulteti hartojnë përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithëshme që duhet të plotësojnë kandidatët për t'u pranuar në MPAB. Këto kriteret miratohen nga senati akademik dhe publikohen në faqen zyrtare. Referuar vendimit të senatit për kriteret e vitit akademik 2022-2023, aksesuar nga GVJ në faqen zyrtare të internetit, rezulton se kriteret</p>




<p>strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>janë vetem kritere të përgjithshme. Kriteri për tu pranuar, është mesatarja e ponderuar e nivelit të pare të studimeve. (<a href="https://uniel.edu.al/images/universiteti/senati/vendime/Vendim-nr-03-date-04-02-2021.pdf">https://uniel.edu.al/images/universiteti/senati/vendime/Vendim-nr-03-date-04-02-2021.pdf</a>; <i>Kriteret e pranimit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani 2021-2022 (uniel.edu.al), )</i></p> <p><i>GVJ nuk konstatoi ndonjë bashkëpunim me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sic kriteri paraqet, duke qenë se këtu bëhet fjalë për studentë që kanë përfunduar minimalisht një program studimi të nivelit bachelor.</i></p> <p><i>(EVIDENCA 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe procedurat e pranimit së studentëve janë të publikuara në webin zyrtar të UNIEL dhe mund të aksesohen nga të gjithë të interesuarit. Aktet rregullatore janë të aksesueshme edhe nëpërmjet sistemit informatik të institucionit, pasi kandidatët fitojnë statusin e studentit. Informacioni për studentët ofrohet edhe për mundësitë e përfitimit të bursës, transferimet, oraret mësimore si dhe për kalendarin e provimeve. GVJ konstaton në DVV, se institucioni për të rritur vizibilitetin, IAL harton broshura si dhe publikon video promovuese</p> <p><i>(Njoftime (uniel.edu.al; EVIDENCA 5.5 Fletëpalosjet promovuese institucionale.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ duke iu referuar DVV si dhe webit të instituconit, konstaton se UNIEL, realizon informimin e publikut për kërkesat e pranimit në MPAB nëpërmjet webit të institucionit, ditëve informuese si dhe videove promovuese dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve informuese.</p> <p><i>(Kriteret e pranimit ne UE 2021-2022.pdf (uniel.edu.al)Njoftime (uniel.edu.al; EVIDENCA 5.5 Fletëpalosjet promovuese institucionale.pdf; EVIDENCA 5.3 Kalendar i ditëve të hapura 2022.pdf; E)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të</p>	<p>Referuar dokumentacionit si dhe takimit me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, ata propozojnë kriteret dhe kuotat për PS MP AB, të cilat miratohen nga senati akademik si dhe nga bordi i admnistrimit dhe i përcillen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Përcaktimi i kriterëve për shtresat e marginalizuara si dhe për kandidatët nga shtete të tjera, mbështetet në udhëzimet e MAS.</p>

veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<p>Për sa më sipër, GVJ konsultoi webin e institucionit dhe konstaton se institucioni i publikon në faqen zyrtare, kriteret për pranimin në programet e studimit.</p> <p><i>(Kriteret e pranimit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani 2021-2022 (uniel.edu.al); <a href="https://uniel.edu.al/njoftime-uniel/241-njoftim-mbi-kriteret-e-pranimit-te-kandidateve-te-rinj-ne-ciklin-e-dyte-te-studimeve">https://uniel.edu.al/njoftime-uniel/241-njoftim-mbi-kriteret-e-pranimit-te-kandidateve-te-rinj-ne-ciklin-e-dyte-te-studimeve</a>)</i></p>
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<p>Referuar njoftimeve në faqen zyrtare të institucionit, rezulton se kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e tjera si dhe kuotat për ta janë hartuar në përputhjes me udhëzimin e MAS nga departamenti, janë miratuar nga senati akademik dhe bordi i administrimit i UNIEL, si dhe janë publikuar për informim të gjerë të palëve të interesuara. Fokusi i këtyre kriterëve, vendoset tek mesatarja e ponderuar e studimeve të nivelit të parë.</p> <p><i>(Kriteret e pranimit ne UE 2021-2022.pdf (uniel.edu.al); Kriteret e pranimit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani 2021-2022 (uniel.edu.al); <a href="https://uniel.edu.al/njoftime-uniel/241-njoftim-mbi-kriteret-e-pranimit-te-kandidateve-te-rinj-ne-ciklin-e-dyte-te-studimeve">https://uniel.edu.al/njoftime-uniel/241-njoftim-mbi-kriteret-e-pranimit-te-kandidateve-te-rinj-ne-ciklin-e-dyte-te-studimeve</a>)</i></p>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Referuar faqes zyrtare të internetit të institucionit si dhe DVV, GVJ konstaton se insitucioni ofron informacion të plotë për përfitim të bursave, në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Këto bursa parqiten si bursa merite ose bursa financiare apo përjashtim nga pagesat e tarifave për shtresat në nevojë në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Në DVV insitucioni vendos në dispozicion edhe vendime të BOA për bursat.</p> <p><i>(Njoftime (uniel.edu.al; EVIDENCA 5.15 Njoftime për informimin e studentëve.pdf)</i></p>
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ, mbështetur në dokumentacion në DVV si dhe nga vizita në institucion, është e mendimit se institucioni, harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit MPAB. Këto gjenden në rregulloren e institucionit, të fakultetit, të programit si dhe ato publikohen e janë të aksesueshme në web si dhe në sistemin e manaxhimit të informacionit EMS, të institucionit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga vizita në institucion si dhe nga DVV, GVJ konstaton se UNIEL ofron informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregulloren e UNIEL, të FE, rregulloren e Departamentit të Administrim Biznesit. GVJ vlerëson se ky informimin bëhet në forma alternative, nëpërmjet sekretarisë mësimore, nëpërmjet sistemit SIM, nëpërmjet webit të fakultetit.  <i>(EVIDENCA 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL.pdf; EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit.pdf; EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.pdf; Njoftime (uniel.edu.al; EVIDENCA 5.5 Fletëpalosjet promovuese institucionale.pdf; EVIDENCA 3.7 Udhezues praktik për provimet online.pdf)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Studentët, rezultojnë se informohen parimisht nëpërmjet akteve të cituara në kriterin më sipër, por edhe rast pas rasti, kur kërkesat janë për kualifikime të mëparshme, nëpërmjet zyrës së kurrikulës dhe departamentit të Administrim Biznesit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Referuar DVV, por edhe takimeve me studentët e programit si dhe stafin e programit, GVJ konstaton se studentët informohen në disa forma, nëpërmjet web, sistemit informatik si dhe nga pedagogët e cdo lënde në orën e pare të semestrit për syllabuset, detyrimet lëndore, kriteret e vlerësimit etj.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e	Për GVJ rezultojnë se informimi për punimin e diplomës, ofrohet nëpërmjet sistemit informatik, sekretarive për afatet dhe detyrimet



punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	që duhen përmbushur para diplomimit, nga udhëheqësit e studentëve si dhe nëpërmjet Manualit të punimit të diplomës. <i>(EVIDENCA 3.5 Manuali i punimit të diplomës.pdf)</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Rezultoni nga DVV se institucioni organizon ditë informuese dhe orientuese për student të ardhshëm të programit sipas një kalendari që gjendet në dosjen e vetëvlerësimit si dhe nëpërmjet videove promovuese dhe fletëpalosjeve. Gjithsesi konsideruar numrin e ulët të studentëve të programit, <i>GVJ sugjeron</i> që institucioni të bëjë përpjekje më organike dhe ti diversifikojë ato, për rritjen e numrit të studentëve. <i>(EVIDENCA 5.2 Fletëpalosjet promovuese institucionale.pdf; EVIDENCA 5.3 Kalendari i ditëve të hapura 2022.pdf; EVIDENCA 5.4 Publikimi i spotit promovues.pdf)</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se institucioni ofron mundësi informimi për studentët për kriteret e vlerësimit, për detyrimet lëndore, për punimin e tëmës së diplomës si dhe informim për studentët e ardhshëm. Gjithsesi konsideruar numrin e ulët të studentëve të programit, GVJ sugjeron që institucioni të bëjë përpjekje më organike dhe ti diversifikojë ato, për rritjen e numrit të studentëve.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstatoi se institucioni informon studentët me informacion të plotë lidhur me programin. Ky informacion konsiston, në kohëzgjatjen e programit, strukturën e cdo semestrin, formën e organizimit, detyrimet që studentët kanë etj.  GVJ konstatoi se ky informim realizohet nga departamenti i Administrim Biznesit, strukturat e sekretarisë mësimore si dhe struktura e Sektorit të Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit.




	<p>Studentët rezultojn se informohen gjithashtu në distancë nëpërmjet faqes zyrtare, videove promovuese dhe broshurave që paraqesin informacion për programin si dhe sistemin elektronik të EMS. Studentët informohen nga strukturat e mësipërme për strukturën e vitit akademik, për kalendarin e provimeve, për orarin mësimor, detyrimet studentore etj.</p> <p><i>(EVIDENCA 5.2 Fletëpalosjet promovuese institucionale.pdf; EVIDENCA 5.3 Kalendarin e ditëve të hapura 2022.pdf; EVIDENCA 5.4 Publikimi i spotit promovues.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se gjatë takimeve me drejtues të njësisë bazë, me stafin e programit dhe studentët e PS në MPAB, se cdo pedagog gjatë javës së parë të cdo viti, informon në mënyrë specifike për studentët për lëndën, syllabusin, literaturën dhe detyrimet akademike të cdo lënde, format dhe skemat e vlerësimit që janë të sanksionuara në rregullore dhe në syllabuse, etj</p> <p><i>(Evidenca Syllabuset; EVIDENCA 4.17 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit.pdf; EVIDENCA 3.7 Udhëzues praktik për provimet online.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka krijuar Bordin Këshillimor të Punës si një strukturë këshilluese e suportive me drejtues të institucioneve dhe bizneseve në rajonin e Elbasanit. Por sic rezultoi edhe nga takimi me studentët e programit, strukturat e brendshme të institucionit, zyra e këshillimit të Studentëve dhe ajo e këshillimit të karrierës, duhet të promovojnë më shumë aktivitetet informuese dhe nxitëse për punësimin e studentëve. Nga takimi me përfaqësues të zyrës së këshillimit të studentëve dhe asaj të karrierës, rezultojn se këto zyra zhvillojnë aktivitete për orientimin në tregun e punës, por këto aktivitete deri tani rezultojnë të pakta dhe sporadike.</p> <p><i>GVJ rekomandon</i> që aktiviteti i këtyre zyrave të jetë më i organizuar, më viziël, më proaktiv, me frekuent, mbështetur në aktivitete të përshatura me nevojat e studentëve, sipas programeve të studimit, për të rritur mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës të studentëve.</p> <p><i>(Evidenca Syllabuset; EVIDENCA 5.6 Të dhëna mbi studentët përfitues të programit të nxitjes së punësimit.pdf; Evidenca 4.6 Aktiviteti I Bordit të Punës)</i></p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët rezultojnë të informuar rreth procesit mësimor, lëndëve, programeve, formave të vlerësimit, infrestrukturës në shërbim të tyre etj. Rezultoi se institucioni realizon edhe open days për studentët e rinj sipas një kalendari informues. Pavarësisht për sa më sipër, sic rezultoi edhe nga takimi me studentët, strukturat e posacme të mbhtetjes së studentëve duhet të informojnë, orientojnë dhe motivojnë nëpërmjet praktikave të mira, studentët për mobilitetet dhe programet e shkëmbimit studentor, për pjesëmarrjen në aktivite, për mundësitë e punësimit etj</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ konstaton gjatë vizitës në institucion, se sistemi EMS mundëson akses në informacion lidhur me procesin mësimor, syllabuset, leksionet e parashkuara apo prezantimet ne ppt, detyrimet lëndore, oraret e mësimit dhe kalendarin e provimeve, vlerësim e cdo lënde. Nëpërmjet këtij sistemi rezulton se studentët mund të aksesojnë edhe bibliotekën elektronike. Nga takimi me studentët rezultoi se ata aksesonin lehtësisht dhe në mënyrë frekvente informacionin më sipër gjatëvitit akademik.</p> <p><i>(EVIDENCA 4.12 Rregullorja EMS.pdf)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ është e mendimit se institucioni informon për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet nëpërmjet sekretarisë mësimore, stafit akademik si dhe EMS. GVJ është e mendimit se institucioni duhet të ketë një aktivitet më efektiv të zyrave të këshillimit të karrierës për mundësitë e punësimit si dhe të mundësive të programeve të shkëmbimeve studentore</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p>X</p>	

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga takimet me drejtues të njësisë bazë dhe me sekretarine, konstaton se UNIEL harton dhe</p>




<p>mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në PS MPAB.</p> <p>Referuar rregjistrave themeltar, nga vizita ne institucion rezulton se numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për vitin akademik:</p> <p>2019-2020 13 studentë;</p> <p>2020-2021 19 studentë;</p> <p>2021-2022 13 studentë;</p> <p>2022-2023 17 studentë</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ referuar të dhënave dhe regjistrave që institucioni mban, konstaton se UNIEL mban të dhëna të vazhdueshme për ecurinë e studentëve deri në diplomim, vlerësimet e tyre në cdo lëndë, rregjistrime këto që përvec procesverbaleve analitike të cdo lënde në hard copy, hidhen edhe në regjistrat themeltar ku çdo student rezulton i regjistruar dhe ishte pajisur me numer matrikullimi. Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e shkollës së mesme dhe e bachelorit, listë notash, fotokopje e kartës së identitetit, mandatë pagesë, etj</p> <p>Numri i studentëve të crregjistruar, për vitin akademik rezulton:</p> <p>2019-2020 0 studentë;</p> <p>2020-2021 1 studentë;</p> <p>2021-2022 0 studentë;</p> <p>2022-2023 0 studentë</p> <p><i>EVIDENCA 2.19 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht</p>	<p>GVJ konstatoi se, të dhënat për studentët si regjistrimet, vlerësimet e cdo lende, detyrimet akademike të studenteve, mbahen manualisht si dhe në mënyrë elektronike në sistemin e informacionit EMS, nga sekretaria, sipas procedurave që parashikohen në statutin e UNIEL dhe ne rregulloren e UNIEL. Këto forma të kombinuara të mbajtjes së të dhënave, fizikisht dhe elektronikisht, GVJ i vlerëson pozitivisht, sepse rrisin sigurinë e</p>

të verifikueshme nga personat e autorizuar.	ruajtjes së të dhënave, por edhe shpejtësinë e sigurimit të informacionit nga përdoruesit e autorizuar të sistemit.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar, konstaton se proceset mbikëqyrëse si dhe strukturat që kanë përgjegjësinë e kryerjes së procesve mbikëqyrëse dhe të monitorimit janë të sanksionuara në rregulloren e institucionit si dhe në rregulloren e sistemit elektronik të menaxhimit të informacionit EMS.  <i>(EVIDENCA 4.12 Rregullorja EMS.pdf; EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.pdf EVIDENCA 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL.pdf)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ iu vu në dispozicion nga institucioni të dhëna për cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të cilat rezultojnë se janë pjesë e analizave periodike që departamenti i Administrim Biznesit bën apo raporteve vjetore në nivel institucioni. UNIEL disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi (mesataren në hyrje dhe në dalje), deri në diplomimin e tyre dhe rezultojnë se i analizojnë ato në analizat vjetore.  GVJ rekomandon se Strukturat e zyrës Alumni duhet të sigurojnë të dhëna të detajuara për punësimin e studentëve të diplomuar dhe duhet të jenë më proaktive në krijimin e lidhjeve më efektive me sipërmarrësit, institucionet publike dhe vendimmarrësit lokalë, për rritjen e punësimit të studentëve të diplomuar në PS në MPAB. Këto aktivitete duhet të jenë më frekvente dhe të promovojnë punësimin e studentëve, por edhe arrijtjet në punësimin e studentëve pas përfundimit të PS në MPAB, duke i shërbyer edhe promovimit të programit dhe suksesit të Alumnit të programit  <i>(EVIDENCA 5.7 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarëve 2020-2021.pdf)</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ është e mendimit se institucioni administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit MPAB, nga pranimi deri në diplomim.</i>

	<i>GVJ sugjeron rritjen e efektivitetit të zyrës Alumni, për paragjurmin dhe gjurmimin e studentëve edhe nëpërmjet pyetësorëve, për të pasur informacion sa më të plotë dhe të azhurnuar në nivel programi për punësimin e studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>E drejta për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është e sanksionuar në LAL 80/2015, dhe në Statutin e UNIEL. GVJ konstatoi nga RVB dhe nga informacioni në DVV se studentët janë të përfaqësuar në disa komisione të përherëshme si, komisione të Sigurimit të cilësisë, të Kurrikulës, të Marrëdhënieve me studentët si dhe në komisionin zgjedhor, etj. Gjithashtu rezultojnë studentët e UNIEL janë të përfaqësuar në senat dhe në bordin e administrimit mbas riorganizimit të bordeve të administrimit. Përfaqësimi i tyre në këto nivele vendimmarrëse, krijojnë mundësinë e përfaqësimit të kërkesave të tyre në vendimmarrjen e UNIEL.</p> <p><i>(EVIDENCA 5.8 Vendimi për Komisionin Institucional Zgjedhor.pdf;</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.10 Urdhri për komisionet e përherëshme institucionale në UNIEL (2).pdf;</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.11 Urdhri për komisionet e përherëshme në fakultet.pdf; EVIDENCA 5.12 Urdhri për grupin e punës për raportin e vetëvlerësimit për programet FSHE.pdf)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose	Referuar dosjes së vetëvlerësimit, studentët rezultojnë pjesë e komisioneve të vetëvlerësimit të institucional dhe programor. Pjesëmarrja e tyre në këto procese të vlerësimit të brendshëm,

<p>përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>krijon mundësinë që studentët të përcjellin perceptimin e tyre, sugjerimet e tyre për proceset mësimore, funksionimin e strukturave të institucionit etj. Studentët përcjellin mendimet e tyre edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në anketimin që bëhet cdo semestër për vlerësimin e procesit akademik.</p> <p><i>(EVIDENCA 5.9 Urdhri për Komisionit të Vetëvlerësimit për Akreditimin Institucional.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga takimi me drejtues të njësisë bazë, rezultoi se përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të PS në MPAB, është indirekte nëpërmjet feedbackut që njësia bazë merr prej pyetësorit të studentëve që zhvillohen dy herë në vit nga NJSBC, si dhe nëpërmjet përfshirjes së tyre në GVB.</p> <p>GVJ vlerëson përfshirjen e studentëve në anketat e zhvilluar për vlerësimin e procesit mësimor, megjithatë <u>rekomandohet</u> që krahas zhvillimit të pyetësorit të përdoren edhe instrumenta të tjerë në funksion të përmirësimit të programit, nepermjet përfshirjes së perceptimit të studentëve. Psh, zhvillimi i fokus grupeve, apo mbledhjeve të hapura të departamenteve, me pjesëmarrjen e studentëve etj. Këto mund të shërbejnë si instrumente për të matur perceptimin e studentëve në raport me programin e studimit në tërësi dhe përmirësimin e tij në vazhdimësi, nëse pyetësorët nuk e ofrojnë këtë informacion</p> <p><i>(EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit.pdf; EVIDENCA 1.8 Rregullore e Universitetit.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre. Referuar takimeve me stafin akademik dhe me studentët, mbas hedhjes së notave në sistemin EMS, studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit, konsultimit me tezën e provimit e më pas pedagogu i lëndës vendos notën përfundmtare. Nëse studenti serish e ankimon këtë rezultat, dekani ngre një komision të ri për rishikimin e rezultatit. Gjithashtu nëpërmjet anketimeve semestrare, studentët kanë të drejtë të shprehin perceptimet e tyre mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.</p> <p><i>(EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit.pdf; EVIDENCA 1.8 Rregullore e Universitetit.pdf)</i></p>




<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ është e mendimit se studentët rezultojnë të përfaqshuar në një sërë komisionesh dhe strukturash vendimarrëse, por referuar takimeve me studentët, <u>GVJ sugjeron një përfshirje me proaktive të tyre.</u></i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Njëqind për qind</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstaton se UNIEL nëpërmejt njësive të posaçme në strukturën organizative, zhvillon procedura në shërbim të informimit të studentëve mbështetur në statutin edhe rregulloren e UNIEL. Përsa më sipër është Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, të cilët në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe atë bazë, informojnë studentët.  <i>(EVIDENCA 5.15 Njoftime për informimin e studentëve.pdf)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstaton se UNIEL ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar	Referuar Statutit dhe Rregullores së institucionit janë të sanksionuara detyrat që Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit duhet të kryejnë. GVJ konstatoi aktivitete informimi me maturanët të kryer nga kjo zyrë mbi bazën e një kalendari paraprak, aktivitete informimi për studentët e vitit të parë.



<p>informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Pavarësisht për sa më sipër, GVJ është e mendimit se Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, duhet të planifikojë dhe të organizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe më të shpeshtë, aktivitete informuese dhe orientuese për studentët, në lidhje me praktikat profesionale dhe punësimin e tyre të ardhshëm.</p> <p><i>Rekomandohet një kombinim më i përshtatshëm midis aktivitetit të zyrave administrative dhe sistemit të këshillimit në bazë të secilit departament. Kjo do të mundësojë ngritjen e një sistemi më të përshtatshëm të informimit, këshillimit dhe asistencës së vazhdueshme për studentët në lidhje me praktikat profesionale apo me punësimin e ardhshëm, apo për ndarjen e eksperiencave të studentëve në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+ etj.</i></p> <p><i>(EVIDENCA 5.15 Njoftime për informimin e studentëve.pdf)</i></p>
---	--

<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatoi se UNIEL ka krijuar Rrjetin Alumni, ku vihet re se numri i ish-studentëve të PS Administrim Biznesi, në Alumni të UNIEL është ende i vogël. <i>GVJ sugjeron</i> intensifikimin e përpjekjeve të këtyre strukturave për të gjurmuar studentët si dhe për një orientim e lidhje më të fortë me tregun e punës.</p> <p><i>(Evidenca 5.6)</i></p>
---	--


<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ është e mendimit se institucioni duhet të rrisë efektivitetin e zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, për të siguruar një lidhje më të mirë me tregun e punës dhe një orientim më të mirë të studentëve dhe gjurmim më të plotë të tyre.</i></p>
---------------------------	---

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		<b>X</b>	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		<b>X</b>	

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ referuar dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimeve me stafin akademik dhe atë drejtues të programit, konstaton se institucioni në kushtet e mësimit në distance për shkak të pandemisë, ka hartuar dhe publikuar një udhëzues në nivel institucional për mësimdhënien on-line, për tu përshtatur me kushtet e reja mjedisore.</p> <p><i>(EVIDENCA 6.1 Guida e pedagogut Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion dhe takimeve me strukturat drejtuese dhe mbështetëse, GVJ konstaton se strukturat e njësisë bazë, njësisë kryesore përgjegjëse për programin si dhe sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të cilësisë në nivel IAL si dhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zbatojnë disa instrumenta të monitorimit të mësimdhënies, si kontrolle të zhvillimit të mësimit, aplikimin e pyetësorëve si instrument i vlerësimit të procesit të mësimdhënies, vlerësimit të performancës së stafit akademik në disa fusha, etj.</p> <p><i>(Skeda e vlerësimit.pdf; EVIDENCA 6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionalë 2021-2022.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit si dhe me stafin e zyrës së Kurrikulës dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezulton se pyetësori zhvillohet para përfundimit të cdo semestri dhe synon përfshirjen sa më të gjerë të studentëve të programit për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, format alternative të saj, vlerësimin e dijeve etj.</p> <p><i>(Evidenca:Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionalë 2021-2022.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në</p>	<p>Gvj konstatoi se pavarësisht sugjerimeve për rishikimin e pyetësorit dhe ndarjen e rezultateve të tij me stafin akademik, Sektori i Kurrikulave dhe SBC, harton një raport vjetor me rezultatet e pyetësorit, i cili shqyrtohet nga Komisioni i SBC në</p>

mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	UNIEL që bën edhe rekomandimet e mëtejshme. Ky raport rezulton se publikohet.  (EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.pdf)			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Pavarësisht se raporti publikohet në terma të përgjithshëm të gjetjeve, <u>GVJ sugjeron</u> që në këto raporte të identifikohen shembujt dhe praktikat e mira, për promovimin e kulturës së cilësisë, sikurse edhe diskutimin në rang departamenti të gjetjeve kryesore në terma të përgjithshëm si dhe ndarjen me stafin në mënyrë konfidenciale të rezultateve të vlerësimit të secilit pedagog.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ lidhur me këtë standard, është i mendimit se UNIEL, ka një politikë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të mësimdhënies.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Referuar strukturave të sigurimit cilësisë, rezulton se UNIEL, ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Cilësisë në nivel IAL (sipas ligjit 802015), Sektorin e Kurrikulës dhe SBC, në nivel IAL, që kryejnë procedurat administrative për monitorimin e cilësisë, organizimin e pyetësorit, përpunimin e tij dhe hartimin e raportit si dhe strukturat e njesisë bazë dhe kryesore, të cilat ndjekim monitorimin e vazhdueshëm të mbarëvajtjes së programit të studimit MPAB.  (Skeda e vlerësimit.pdf; EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.pdf;

	<i>EVIDENCA 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme institucionale në UNIEL (2).pdf)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Referuar përbërjes së Komisionit të Sigurimit të Cilësisë, ai rezulton të kryesohet nga Zv. Rektori, ka një përfaqësues për çdo njësi kryesore dhe një përfaqësues i studentëve. Nuk u konstatuan në përbërje të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë, ekspertë të jashtëm.  <i>(Skeda e vleresimit.pdf; EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.pdf; EVIDENCA 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme institucionale në UNIEL (2).pdf)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasues, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	UNIEL rezulton të ketë përfunduar akreditimin institucional si dhe i nështrohet akreditimit programor, sic është edhe ky proces vlerësimi. Përveç akreditimit institucional si sigurimi i jashtëm i cilësisë, institucioni realizon procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë nga NJSBC. Referuar raportit të cilësisë, rezulton se analizohen disa indikatorë në terma sasiorë sipas frekuencës në përgjigje të studentëve, për pyetjet që përmban pyetësori dhe mbi to, konstatohet se janë lënë rekomandime nga grupi zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, për të cilat strukturat respektive të UNIEL, duhet të ndjekë plotësimin e tyre në vazhdimësi.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Nga dosja e vlerësimit të brendshëm dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se përdoren disa mekanizma, si monitorim i vazhdueshëm nga njësia bazë/kryesore, sondazhi i studentëve me një periodicitet dy herë/vit si dhe vlerësimi i performancës nga njësia bazë të mesimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe monitorimi i procesve të mësimdhënies. Sic u konstatua dhe diskutua edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ <u>sugjeron</u> rishikim të pyetësorit, për të bërë një vlerësim më të plotë faktorëve që ndikojnë cilësinë e mësimdhënies si dhe përdorimin e më shumë mekanizmave vlerësues, sic janë forma të ndryshme të pyetësorëve apo/edhe fokus grupet me studentë.  <i>(Skeda e vleresimit.pdf; EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.pdf;</i>

	<i>EVIDENCA 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme institucionale në UNIEL (2).pdf).</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se UNIEL, harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit MPAB, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. <u>GVJ sugjeron</u> që IAL të bëjë rishikim të instrumentit-pyetësorit, për të bërë një vlerësim më të plotë faktorëve që ndikojnë cilësinë e mësimdhënies si dhe përdorimin e më shumë mekanizmave vlerësues, sic janë forma të ndryshme të pyetësorëve apo/edhe fokus grupet me studentë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.  Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen	GVJ konstatoi se IAL përdor mekanizëm formal - sondazhe cdo fund semestri, për të vlerësuar aspekte të cilësisë së programeve të studimit. Nga vizita në institucion dhe takimet me përfaqësues të zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, rezultoi se rezultatet e sondazheve të studentëve dokumentohen dhe analizohen, hartohet në vijim një raport përmbledhës që përmban rekomandime sipas gjetjeve, duke synuar të adresojë problematikat e hasura nga sondazhet nëpërmjet drejtuesit të njësisë bazë, të njësisë kryesore apo strukturave të tjera që kanë në përgjegjësinë e tyre problematikën e identifikuar (nga diskutimet me përfqësuesit e NJSBC, një nga problematikat ka rezultuar infrastruktura).  Një mekanizëm tjetër i përdorur, është vlerësimi i performancës së stafit në mënyrë të vazhdueshme, nga njësia bazë, mbështetur në bazën ligjore. Gjithashtu institucioni nëpërmjet një procesi formal, ka ngritur GVB, që ka hartuar RVB dhe ka përgatitur dosjen e vetëvlerësimit për qëllim akreditimi, dokumentacionit të së cilës, i jemi referuar vazhdimisht si GVJ, gjatë këtij procesi.

dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	
<b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Referuar RVB, rezulton se raporti i vlerësimit të brendshëm, përmban pikat e forta dhe të dobta të PS MPAB. Gjithashtu referuar raportit vjetor të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ai përmban analizën e gjetjeve kryesore dhe rekomandime të lëna për adresimin e problematikave, për strukturat specifike akademike dhe/ ose administrative të UNIEL,  <i>(Skeda e vlerësimit.pdf; EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.pdf; EVIDENCA 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme institucionale në UNIEL (2).pdf; EVIDENCA 5.9 Urdhri për Komisionit të Vetëvlerësimit për Akreditimin Institucional.pdf; Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.pdf)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ konstatoi se në MPAB, përdoren metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, të cilat shihen se janë të përfshira në seksionet e pyetësorit që aplikohet deri tani, në sondazhet e studentëve.  <i>(EVIDENCA 2.24 Draft pyetësor për mësimin në distancë.pdf)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të	Sic GVJ është shprehur edhe për vlerësimin e kriterëve më sipër, UNIEL për vlerësimin e cilësisë, përdor sondazhin e studentëve,

<p>realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>monitorimin e procesit mësimor dhe vlerësimin e performances së stafit akademik. Përfshirja e Bordit Këshillimor të Biznesit, krijon mundësi për të tërhequr opinionin e tyre dhe sugjerimet për përshtatjen me kërkesat në zhvillim të tregut të punës për aftësi dhe zotësi që studentët e diplomuar duhet ti kenë, në përfundim të MPAB për të qenë më konkurrues në tregun rajonal dhe më gjerë.</p> <p><i>GVJ sugjeron</i> që IAL të bëjë rishikim të pyetësorit, për të bërë një vlerësim më të plotë faktorëve që ndikojnë cilësinë e mësimdhënies si dhe përdorimin e më shumë mekanizmave vlerësues, sic janë forma të ndryshme të pyetësorëve apo/edhe fokus grupet me studentë, formave të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta.</p>
--	--

<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ është e mendimit se UNIEL monitoron dhe vlerëson përmes KSBC, NJSBC, njësisë bazë dhe kryesore, në mënyrë periodike programin e studimit, MPAB, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. Pavarësisht për sa më sipër, <i>GVJ sugjeron</i> që IAL të përfshijë më shumë mekanizma të diversifikuar të drejtëpërdrejta dhe të tërthortë në vlerësimin e programit të studimit MPAB.</i></p>
---------------------------	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

<p><b>Standardi VI.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe</p>	<p>Në përbërje të Komsionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezulton se cdo njësi kryesore ka përfaqësues të saj si dhe studentët përfaqësohen nga një anëtar, duke garantuar përfaqësim të gjithë</p>

<p>procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>aktorëve të brendshëm, staf akademik dhe studentë. Nuk u konstatuan ekspertë të jashtëm, por theksojmë se institucioni ka krijuar Bordin Këshillimor të Biznesit, që parimisht mund të sjell një këndvështrim të rënësishëm, nën optikën e tregut të punës, në vlerësimin e programeve të studimit.</p> <p><i>(EVIDENCA 4.6 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillor të Biznesit 2021-2022.pdf; EVIDENCA 6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionalë 2021-2022.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ nuk konstatoi një guide ose rregullore të KSBC apo të sektorit të Kurrikulës dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, por detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre, gjenden në rregulloren e njësisë kryesore dhe atë të UNIEL.</p> <p><i>(EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.pdf; EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se anëtarët njësisë kryesore janë pjesë e KSBC dhe NJSBC përveç faktit që sic rezultoi nga vizita në institucion, anëtarët e departamentit janë pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm programor. Gjithashtu studentët kanë përfaqesin e vetë në KSBC, në NJSBC si dhe në GVB. Përfshirja e të gjitha palëve krijon mundësinë e sjelljes së këndvështrimeve të ndryshme dhe adresimin e çështjeve që janë me interes të gjerë për cilësinë e PS MPAB, si për stafin akademik, studentët dhe UNIEL në tërësi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo</p>	<p>GVJ konstatoi se pyetësorët zhvillohen anonim, që studentët të trajtojnë me sa më shumë objektivitet informacionin konfidencial, përpunimi i tyre dhe analizimi bëhet në tërma të përgjithshëm, publikimi i gjetjeve është në respekt të integritetit akademik dhe synon të shmangë diskriminimin apo pabarazinë kundrejt personelit të vlerësuar dhe studentëve që kanë vlerësuar.</p>



pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.									
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nuk u konstatuan ekspertë të jashtëm në KSBC apo NJSBC, por theksojmë se institucioni, ka krijuar Bordin Këshillimor të Biznesit, që parimisht mund të sjell një këndvështrim të rëndësishëm, nën optikën e tregut të punës, në vlerësimin e programeve të studimit.  <i>(EVIDENCA 4.6 Lista e aktiviteve të Bordit Këshillor të Biznesit 2021-2022.pdf)</i>								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ është e mendimit se UNIEL përfshin të gjithë aktorët e brendshëm, staf akademik, njësi kryesore, bazë, KSBC dhe NJSBC, në sigurimin e cilësisë. Në këto struktura ka përfaqësues të studentëve. Raporti me gjetjet e trajtura në mënyrë të përgjithshme dhe rekomandimet, publikohen.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për	GVJ referuar DVV dhe webit zyrtar të UNIEL si dhe EMS, konstaton se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.  <i>(EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.pdf; 6.5.Kodi I Etikes; Evidenca 6,6. Plani strategjik i programit; EVIDENCA 6.7</i>

studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<i>Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.pdf)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Vendimet e senatit lidhur me raportin dhe rekomadimet e lena si dhe raporti i analizes së pyetësorëve të studentëve, rezultojnë të publikuar në faqen zyrtare. Raporti respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.  <i>(EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.pdf; EVIDENCA 6.7 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.pdf)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Ky raport rezulton të ketë të përcaktuara edhe masat për përmirësim të mëtejshëm në nivel institucioni, edhe pse GVJ është e mendimit se raporti duhet të jetë më i detajuar dhe rekomandimet me specifike GVJ konsultoi dy raporte, të vitit 2020-2021 dhe të vitit 2021-2022. Raportet përmbajnë gjetjet kryesore dhe rekomandimet e lëna për adresimin e problematikave. GVJ konstaton se njësia bazë ka hartuar dhe planin strategjik të programit të studimit për të siguruar mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e programit të studimit MPAB.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Sipas RVB, sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, raporton në mënyrë të vazhdueshme në senat, për procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, në të cilën adresohen edhe rekomandime mbi gjetjet e sondazhit të studentëve, edhe pse <i>GVJ sugjeron</i> që raporti duhet të jetë më i detajuar dhe rekomandimet me specifike dhe të sigurohet ndjkeja e plotësimit të rekmandimeve të lëna
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga takimi me strukturat drejtuese rezulton se UNIEL nëpërmjet strukturave drejtuese, njësi kryesore apo/edhe njësi bazë, organizon veprimtari me stafin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, nëpërmjet promovimit të pjesëmarrjes në trajnime, në projekte dhe në mobilitete të ndryshme, në vende të ndryshme nga ku mund të sigurohen praktika të reja innovative për përmirësimin e cilësisë.  <i>(EVIDENCA 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+.pdf;</i>

	<i>EVIDENCA 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personave FE.pdf; EVIDENCA 3.17 Publikimi i të dhënave, takimeve, aktiviteteve dhe njoftimeve në website UNIEL.pdf)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ është e mendimit se proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit PS në MPAB, janë publike dhe transparente dhe synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe rritjen e qëndrueshmërisë së PS MPAB.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Administrim Biznesi”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Fakulteti Ekonomik dhe Departamenti i Administrim Biznesit gëzojnë një experiencë të gjatë në ofrimin e programit të studimit përgjatë viteve;
2. Infrastruktura që siguron hapësira të mjaftueshme dhe të pajisura me teknologjinë e duhur në shërbim të mësimdhënies efektive;
3. Sistem informacioni i integruar dhe efektiv, për studentët, stafin akademik, stafin administrativ dhe drejtuesit;
4. Cilësia e stafit akademik, ekesperienca profesionale dhe shkencore afatgjatë e tyre dhe përfshirja e lartë e stafit akademik efektiv;
5. Informimi i studentëve në lidhje me programin e studimit dhe komponentëve të tij është i plotë dhe zhvillohet kryesisht nëpërmjet stafit akademik, syllabuseve të lëndëve, EMS sikurse dhe në faqen zyrtare të internetit të vetë institucionit;
6. Bordi Këshillimor i Punës mund të jetë në të ardhmen një mbështetje dhe garanci për lidhje më të mira me tregun punës dhe rritje të punësimit të studentëve;

#### **b. Pika të dobta:**

1. Ndjekja e studentëve e pa mjaftueshme përtej programit të studimit duke forcuar rrjetin ALUMNI; (*Standarti 1.2, Kriteri 5*)
2. Përfshirja e ulët e studentëve në zhvillimin e punëve kërkimore; (*Standarti 2.6, Kriteri 3*)
3. Fondi fizik i bibliotekës për programin e studimit master në Administrim Biznesi ka nevojë për tu azhurnuar dhe zgjeruar me botimet e fundit shqip dhe anglisht në shërbim të studentëve të programit; (*Standardi IV.3, Kriteri 8*)
4. Pamjaftueshmëri për informimin, nxitjen dhe orientimin e studentëve për mundësitë e programeve të shkëmbimit studentor si dhe të mundësive të punësimit të tyre; (*Standardi V.3, Kriteri 2 dhe Kriteri 3*)
5. Pyetëtori i përdorur si mekanizëm për marrjen e feedbackut të studentëve paraqet nevojën për të përfshirë ceshtjë vlerësimi në nivel programor; (*Standardi VI.2, Kriteri 4*)

#### **Rekomandime:**

1. GVJ sugjeron që IAL të rrisi bashkëpunimet me industrinë dhe bizneset për të lehtësuar integrimin sa më të lehtë e të shpejt të studentëve në tregun e punës;
2. GVJ sugjeron që institucioni duhet të inkurajojë dhe mbështesë përfshirjen e stafit dhe studentëve në punë kërkimore me karakter aplikativ dhe shkencor;
3. GVJ sugjeron pasurimin e dhe përditësimin e fondit të bibliotekës fizike me botimet recente të titujve në përputhje me programin e studimit master në Administrim Biznesi;
4. GVJ sugjeron, se UNIEL duhet të sigurojë forma alternative të gjenerimit të fondeve në të ardhmen nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare;
5. GVJ rekomandon që institucioni duhet të rrisë efektivitetin e zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, për të siguruar një lidhje më të mirë me tregun e punës dhe një orientim më të mirë të studentëve dhe gjurmim më të plotë të tyre;
6. GVJ sugjeron që IAL të përfshijë më shumë mekanizma të diversifikuar të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë në vlerësimin e programit të studimit master në Administrim Biznesi si dhe rishikim të pyetëtorit të përdorur si instrument vlerësimi dhe orientimin e tij, për marrjen feedback nga studentët deri në nivel programor;



## Evaluation's conclusions for the first cycle study program Professional Master "Business Administration

### **a. Strengths and affirmations:**

1. The Faculty of Economics and the Department of Business Administration enjoy a long good experience in offering the study program;
2. Infrastructure that provides sufficient spaces and the proper technology for effective teaching.
3. Effective and integrated information system for students, decision-makers, academic and administrative staff;
4. Quality of the academic staff, their long-term experience both scientific and professional, and high involvement of the full-time academic staff;
5. Informing students about the study program and its components is complete and takes place mainly through the academic staff, course syllabuses, EMS as well as on the official website of the institution itself;
6. The Labor Advisory Board can in the future be a support and guarantee for better connections with the labor market and increased student employment;

### **b. Weaknesses**

1. Insufficient follow-up of students beyond the study program by strengthening the ALUMNI network; *(Standard 1.2, Criterion 5)*
2. Low involvement of students in the development of research work; *(Standarti 2.6, Criterion 3)*
3. The physical fund of the library for the master study program in Business Administration needs to be updated and expanded with the latest Albanian and English publications to serve the students of the program; *(Standard IV.3, Criterion 8)*
4. Inadequacy of informing, encouraging and orienting students about the possibilities of student exchange programs as well as their employment opportunities; *(Standard V.3, Criterion 2, Criterion 3)*
5. The questionnaire used as a mechanism for receiving students' feedback represents the need to include assessment issues at the program level; *(Standard VI.2, Criterion 4)*

### **Recommendation**

1. GVJ suggests that HEI should increase cooperation with industry and businesses to facilitate the easier and faster integration of students into the labor market;
2. GVJ suggests that the institution should encourage and support the involvement of staff and students in research work with an applied and scientific character;

3. GVJ suggests the enrichment and update of the physical library fund with recent editions of titles in accordance with the master's study program in Business Administration;
4. GVJ suggests that UNIEL should provide alternative forms of generating funds in the future from national and international projects;
5. GVJ recommends that the institution increase the effectiveness of the Career and Alumni Counseling office, to ensure a better connection with the labor market, better orientation of students, and a more complete tracking of them;
6. GVJ suggests that IAL includes more diversified direct and indirect mechanisms in the evaluation of the master's in business administration study program as well as revision of the questionnaire used as an evaluation instrument and its orientation, for receiving feedback from students even in levels of the program;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Asnjëri nga të dytë	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X